Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

Prokurori i Shtetit
Državni Tužilac
State Prosecutor

# RAPORT VJETOR (JANAR – DHJETOR 2023)
# PËR ZBATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT
# TË PLANIT STRATEGJIK TË SISTEMIT PROKURORIAL 2022-2024

**Maj 2024**

## 1. Hyrje

Plani strategjik i sistemit prokurorial 2022-2024 (Plani) dhe Plani i Veprimit janë miratuar në takimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës të mbajtur më datë 16 mars 2022. Ky plan paraqet kornizën kryesore të planifikimit të politikave për menaxhimin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës për tre vitet e ardhshme. Në po të njëjtin takim është themeluar Grupi punues për monitorimin e zbatimit të këtij Plani.

Bazuar në Planin strategjik, raportimi duhet të bëhet në baza gjashtëmujore, dhe vjetore andaj, ky raport përfshin periudhën janar – dhjetor 2023.

Plani është i ndarë në 6 shtylla kryesore strategjike si në vijim: 1) Profesionalizmi dhe pavarësia në sistemin prokurorial; 2) Efikasiteti dhe efektiviteti në ndjekjen e krimit; 3) Profilizimi i prokurorëve dhe trajtimi i rasteve penale me prioritet; 4) Menaxhimi dhe administrimi në sistemin prokurorial; 5) Integriteti, llogaridhënia dhe etika; dhe 6) Transparenca në sistemin prokurorial. Pjesë e Planit është edhe Plani i Veprimit përmes së cilit janë ndarë shtyllat në 36 objektiva dhe në total ka 164 aktivitete në bazë të të cilave është bërë monitorimi i zbatimit sipas njësive përgjegjëse, treguesve dhe afateve kohore.

Vlerësimi i zbatimit të aktiviteteve është ndarë në pesë (5) kategori:

Aktiviteti është përfunduar në tërësi

Aktiviteti është përmbushur për periudhën raportuese

Aktiviteti është në proces apo ka pak zhvillime

Aktiviteti është i planifikuar për periudhat e ardhshme raportuese

Nuk ka pasur zhvillime

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2023 nga 164 aktivitetet e planifikuara 21 janë të përfunduara tërësisht, 113 janë përmbushur për periudhën raportuese, 5 janë në proces apo kanë pak zhvillime, 21 janë të planifikuara për periudhat e ardhshme raportuese dhe 4 nuk kanë zhvillime *(të paraqitura në përqindje sipas grafikonit të mëposhtëm).*


Zbatimi i aktiviteteve për periudhën janar - dhjetor 2023
2.44%
12.80%
12.80%
3.05%
68.90%
E përfunduar në tërësi
E përmbushur për periudhën raportuese
Në proces apo ka pak zhvillime
Planifikuar për periudhat e ardhshme
Nuk ka zhvillime

Grafikoni 1




Grafikoni 2

Nga grafikoni 2 vërehet se Shtylla 1 ka përqindjen më të lartë të aktiviteteve të përfunduara tërësisht në raport me numrin e aktiviteteve në krahasim me shtyllat tjera, ndërsa Shtylla 3 ka përqindjen më të lartë të aktiviteteve të cilat janë përmbushur për periudhën raportuese.

## 2. Sukseset, Sfidat dhe rekomandimet

Sipas monitorimit dhe vlerësimit nga ana e grupit punues, është një përqindje relativisht e lartë e zbatueshmërisë së Planit të veprimit për periudhën raportuese, duke pasur parasysh po ashtu edhe faktin se shumica e aktiviteteve e kanë afatin për përmbushje fundin e këtij viti.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë aktivitete të shumta si nga Këshilli po ashtu edhe nga Prokurori i Shtetit. Janë miratuar një numër Rregulloresh lidhur me organizimin dhe veprimatrinë e sistemit prokurorial. Ka filluar transmetimi i drejtpërdrejtë i takimeve të

Këshillit dhe janë hapur faqet zyrtare të Facebook dhe Youtube. Është punuar në finalizimin e uebportalit të ri të sistemit prokurorial që pritet të lansohet së shpejti. Janë zhvilluar aktivitete në drejtim të ngritjes së bashkëpunimit të Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, etj.

Në hartimin e raportit ka qenë sfiduese mos raportimi në kohë nga një numër i konsiderueshëm i njësive përgjegjëse që ka shkaktuar vonesa në hartimin e raportit final duke pasur parasysh numrin e madh të aktiviteteve dhe kohën që nevojitet për përpunimin e të dhënave të ofruara.

Një sfidë në zbatim të aktiviteteve mbetet rekrutimi i 7 zyrtarëve për ndërmjetësim, aktivitet i cili ka mbetur i pazbatuar për arsye të mos miratimit të buxhetit nga Qeveria për rekrutimin e këtyre pozitave, edhe përkundër kërkesave të shumta tëë KPK-së lidhur me këtë çështje.

Po ashtu, ka pasur aktivitete minimale për zhvillimin e kampanjave informuese apo fushatave vetëdijësuese për qytetarët lidhur me punën e Prokurorit të Shtetit në pëegjithësi apo ndonjë fushë specifike që ndërlidhet me aktivitetet e KPK-së dhe PSH-së.

Nuk ka arritur që të finalizohet Plani i reagimit emergjent.

Sa i përket zbatueshmërisë së aktiviteteve, për një pjesë të aktiviteteve kemi pasur bisedime dhe prezantim të aktiviteteve me partnerët dhe donatorët ndërkombëtar, siç janë takimet bilaterale dhe ato në kuadër të Strategjisë për Sundimin e Ligjit. Për një pjesë tjetër të këtyre aktiviteteve jemi në pritje të miratimit të ligjeve të cilat e rregullojnë sistemin prokurorial dhe të cilat janë në proces.

Gjatë pranimit të informatave dhe përpilimit të raportit, grupi punues ka dalë me disa rekomandime për aktivitetet për të cilat duhet të ndërmerren veprime për tu përmbushur duke pasur parasysh afatet kohore, si në vijim:

- Të trajtohet analiza e PSRK-së për zbatimin e Strategjisë për Krime të Luftës si dhe të merret qëndrim për iniciativën për hartim të Strategjisë së re apo jo;
- Të hartohet udhëzuesi me rekomandime për trajtimin e rasteve PPP;
- Të ndërmerren më shumë aktivitete për fuqizimin e Zyrës për Mbrojtje dhe ndihmë viktimave.
- Të finalizohen aktivitetet për zbatimin e Rregullores për Veprimtarinë, Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Administratës së KPK-së;
- Të realizohen aktivitete nga Këshilli me Forumin e grave Prokurore;
- Të identifikohen aktivitetet nga njësitë përgjegjëse që kanë të bëjnë me ngritje të kapaciteteve (trajnime) për të cilat nuk është ndërmarrë ende veprime dhe të fillohet angazhimi në drejtim të përmbushjes së tyre;

- Të zhvillohen planet për kampanja informuese siç parashihen me këtë Plan;
- Të organizohen takime me media dhe shoqëri civile në drejtim të fuqizimit të komunikimit të ndërsjellët dhe aktiviteteve të përbashkëta.
- Të finalizohet Plani i reagimit emergjent.

## 3. Informata të detajuara për zbatimin e Planit strategjik (Plani i Veprimit janar – dhjetor 2023)

| 1 | SHTYLLA STRATEGJIKE 1<br>PROFESIONALIZMI DHE PAVARËSIA NË SISTEMIN PROKURORIAL | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.1** | **Objektivi 1: Avancimi i sistemit të rekrutimit të prokurorëve** | | | | **Raportimi<br>Janar – qershor 2023** | **Përditësimi i progresit<br>Korrik – dhjetor 2023** |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **1.1.1** | Analizë e nevojave për rekrutim të prokurorëve | KPK<br><br>NJSHPP | Janar-dhjetor 2022-2024 | Analiza e hartuara | Nuk ka pasur analize te tille per periudhen raportuese | Draft analiza per numrin e nevojshem të prokuroreve e cila është trajtuar në janar 2024 në KPK. |
| **1.1.2** | Rishikimi i aktit nënligjor | Komision i për Çështje Normative | Janar-dhjetor 2022 | Akti nënligjor i rishikuar | Në takimin e KPK-së të datës 17 qershor 2022 është miratuar rregullorja për rekrutimin, provimin, emërimin dhe riemërimin e prokurorëve të shtetit. | |
| **1.1.3** | Zbatimi i sistemit të aplikimit dhe testimit kualifikues në mënyrë elektronike, në procesin e | Komision i për rekrutim<br><br>Administratori i provimit<br><br>SKPK | Janar-dhjetor 2022-2024 | Sistemi i zbatuar | Ne vitin 2022 aplikimi i kandidatëve për prokurorë është bërë në mënyrë elektronike dhe fizike. Ndërsa, testimet janë mbajtur në formë fizike. Nuk janë zhvilluar procedura të rekrutimit në periudhën janar – qershor 2023, përveç | Nuk janë zhvilluar procedura të rekrutimit në periudhën korrik – dhjetor 2023 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | rekrutimit të prokurorëve | | | | dekretimit të njëzetenjë (21) prokurorëve të shtetit më datë 17 mars 2023, proces i filluar në vitin 2022. | |
| | | | | | | |
| **1.2** | **Objektivi 2: Avancimi i legjislacionit për zhvillim në karrierë** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Tregues i | | |
| **1.2.1** | Analizë e nevojave për transferime dhe avancime të prokurorëve | KPK PSH NJSHPP | Janar – dhjetor 2022-2024 | Analiza e hartuar | NJSHPP ka përgatitur analizë për avancime dhe transferime sipas kërkesës së KPK-së e cila analizë është trajtuar edhe nga Komisioni për administrimin e Prokurorive.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Gjatë periudhës raportuese në KPK gjithesej janë dorëzuar 6 kërkesa për avancim dhe transferim të prokuroreve.<br><br>Këto kërkesa janë dorëzuar pas vlerësimit të gjendjes alarmante më të cilin përballet PTHP sidomos ne DKR dhe në DM, kjo për shkak të avancimeve të prokurorëve ne prokurori të | NJSHPP edhe gjate kësaj periudhe ka përgatitur analizë për avancime dhe transferime sipas kërkesës së KPK-së të cilat analiza jane trajtuar edhe nga Komisioni për administrimin e Prokurorive:<br><br>Raportet analitike për nevojat e avancimit të Prokurorëve të Shtetit në Prokurorinë e Apelit si dhe në Departamentin për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Prishtinë (përfshirë NJKEK); |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | tjera si dhe pensionimit të tyre. | |
| **1.2. 2** | Zhvillimi i proceseve të transferimit dhe avancimit në bazë të nevojave të paraqitura nga prokuroritë dhe të vlerësimeve | Komision i për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve | Janar – qershor 2022-2024<br><br>Korrik – dhjetor 2022-2024 | Numri i proceseve të zhvilluara<br><br>Numri i prokurorëve të transferuar dhe avancuar | Më 23 shkurt 2023 janë avancuar tre (3) prokuror të shtetit në Prokurorinë e Apelit, proces i filluar në muajin tetor 2022.<br><br>Më 23 mars 2023 avancim i një (1) prokurori nga DP në DKR Prizren, proces i filluar në dhjetor 2022.<br><br>Më 23 maj 2023 janë avancuar pesë (5) prokuror nga DP në DKR Prishtinë. | Në gusht 2023 janë avancuar dy (2) Prokurorë të Shtetit nga prokuroritë themelore në Prokurorinë Speciale;<br><br>Në nëntor 2023 janë avancuar tre (3) Prokuror të Shtetit nga prokuroritë themelore në Prokurorinë e Apelit;<br><br>Në dhjetor 2023 janë avancuar dy (2) Prokuror të Shtetit në DKR Prishtinë;<br><br>Në dhjetor 2023 janë avancuar dy (2) Prokuror të Shtetit në DM të PTH Prishtinë<br><br>Në gusht 2023 janë transferuar në menyrë të perhershme dy (2) Prokuror të Shtetit nga PTH Ferizaj në PTH Mitrovicë; |
| **1.2. 3** | Ngritje të kapaciteteve për zbatim të Rregullores së re | Komision i për Çështje Normative | Janar – dhjetor 2022 | Takime njoftuese, të mbajtura për të | Nuk ka pasur | u.d. Kryeprokurori i Shtetit gjatë kolegjiumeve të mbajtura me kryeprokurorët dhe gjatë vizitave nëpër prokuroritë e Republikës së |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | për Transferime dhe Avancime | NJSHPP | | gjithë prokurorët | | Kosoëvs i ka njoftuar dhe ka diskutuar me prokurorët lidhur më procedurat dhe kriteret sipas rregullores së re për transferim dhe avancim. |
| **1.2.4** | Përgatitja e Udhëzuesit për zbatim të Rregullores | Komision i për Çështje Normative<br><br>NJSHPP | Janar – qershor 2022 | Udhëzuesi i hartuar | Në takimin e KPK-së të datës 17 qershor 2022 është miratuar udhëzuesi për zbatimin e rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit | |
| | | | | | | |
| **1.3** | **Objektivi 3: Ngritja profesionale e vazhdueshme e prokurorëve dhe personelit** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **1.3.1** | Përcaktimi i politikave të trajnimit për prokurorë dhe staf mbështetës | KPK Prokurori i Shtetit NJSHPP DBNJ në SKPK | Janar - dhjetor 2022-2024 | Dokumenti për politikat e trajnimit, i hartuar | Ky aktivitet eshte i parapare per periudhen e ardhshme raportuese.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Gjatë periudhës raportuese Kryeprokurori ka dorëzuar një liste me rreth 22 tema të ndryshme për trajnimet që i sheh si të arsyeshme që të realizohen për prokuror dhe staf, e për të cilat beson se do të ndikonin në zhvillimin profesional të tyre si dhe | Dokumenti i politikave dhe plani i detajuar për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ për sistemin prokurorial ,është hartuar nga Zyra për trajnime i cili dokument është miratuar nga KPK dhe eshte percjellur ne Akademine Drejtesise per hartimin e moduleve trajnuese. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | zhvillimit të institucionit në tërësi. | Dokumenti përmban Programin e trajnimeve të specializuara, Programin e trajnimeve fillestare, Programin e trajnimeve të vazhdueshme vullnetare dhe të detyrueshme, Trajnmet e avancuara dhe Trajnimet për trajner. |
| **1.3. 2** | Monitorimi i pjesëmarrjes në trajnime | NJSHPP | Janar - dhjetor 2022-2024 | Raporte t e hartuar a<br><br>Udhëzi mi i Kryepro kurorit të Shtetit, i zbatuar | NJSHPP:<br>Pranimi i raporteve të rregullta javore nga ADK, Lista e pjesëmarrjes në trajnim, Ofrimi i raporteve për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnim në fusha të caktuara për KPK dhe mekanizma për sundimin e ligjit në RK, Raporti tre mujor, gjashtë mujor për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnim nga Zyra për trajnime. | NJSHPP:<br>Pranimi i raporteve të rregullta javore nga ADK, Lista e pjesëmarrjes në trajnim, Ofrimi i raporteve për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnim në fusha të caktuara për KPK dhe mekanizma për sundimin e ligjit në RK, Raportin nënët mujor dhe një vjecar për pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnim nga Zyra për trajnime. |
| **1.3. 3** | Vlerësimi i nevojave për trajnime dhe efektit të trajnimeve | SKPK NJSHPP | Janar - dhjetor 2022-2024 | Raporte t e hartuar a | Vlerësimi i nevojave për trajnim për prokurorë dhe staf administrativ dorëzohet në muajin tetor në Njësinë përgjegjëse për trajnime (NJSHPP). | Zyra për trajnime ka koordinuar punën rreth indentifikimit të vlerësimit të nevojave për trajnimin e prokurorëve dhe stafit administrativ, në bashkëpunim me |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Kryeprokurorët dhe Administratorët e të gjitha nivelet të prokurorive, Menaxherët e të SKPK,NJSHPP dhe ZMNV. Indentifikimi i nevojave për trajnim janë dërguar në Zyrën për trajnime me qëllim të hartimi të dokumentit të përbashkët . |
| **1.3.4** | Koordinimi mes KPK-së me Akademinë e Drejtësisë | KPK NJSHPP KVPP | Janar - dhjetor 2022-2024 | Memorandumi i zbatuar | Koordinatori i komisioneve të përhershme të KPK-së, ka hartuar Protokollin Nr.1 për trajnimet e detyrueshme për prokurorët me performancë të dobët. Protokolli është miratuar nga KPK dhe AD dhe është bërë pjesë integrale e marrëveshjes së bashkëpunimit në mes KPK dhe AD. | |
| **1.3.5** | Koordinimi mes KPK-së (Njësisë për Trajnime dhe Burimeve Njerëzore) me IKAP-in | KPK NJSHPP | Janar - dhjetor 2022-2024 | Takimet e mbajtura | Koordinim i vazhdueshëm përmes takimeve, mënyrës elektronike apo/ose varësisht nevojave | Koordinim i vazhdueshëm përmes takimeve, mënyrës elektronike apo/ose varësisht nevojave |
| | | | | | | |
| **1.4** | **Objektivi 4: Ruajtja e pavarësisë së sistemit prokurorial nga ndërhyrjet e jashtme** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **1.4.1** | Përdorimi i rrugëve ligjore për mbrojtje të | KPK PSH | Janar – dhjetor 2022-2024 | Procedurat e ndjekur | KPK dhe ZKPSH:<br>Përmes përfaqësuesve të vet KPK dhe ZKPSH kanë marrë pjesë në të gjitha grupet | KPK dhe ZKPSH:<br>Përmes përfaqësuesve të vet KPK dhe ZKPSH kanë marrë pjesë në të gjitha grupet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | sistemit prokurorial | | | a sipas nevojës | punuese dhe kane ofruar komente për ndryshimet ligjore për sistemin prokurorial, procesin e vettingut, Ligjin e pagave, ligjin për zyrtarët publik, ligjin për Prokurorin e Shtetit, ligjin për PSRK, ligjin për KPK dhe Kodin e Procedurës Penale. Po ashtu, KPK dhe ZKPSH kanë nënshkruar deklaratën e përbashkët të zotimit me institucionet tjera të drejtësisë dhe janë angazhuar maksimalisht në të gjitha grupet punuese për zbatimin e aktiviteteve të planit të veprimit të kësaj deklarate.<br><br>Gjatë kësaj periudhe ka pasur edhe një numër të konsiderueshëm të rasteve kur KPK ka lëshuar reagime publike në mbrojtje të anëtarëve të KPK-së dhe prokurorëve për shkak të cenimit të pavarësisë së punës së tyre nga palë të ndryshme. | punuese dhe kane ofruar komente për ndryshimet ligjore për sistemin prokurorial ne kuader te Deklarates se Perbashket te Zotimi.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Gjatë kësaj periudhe raportuese janë përdorur të gjitha rrugët për mbrojtjen e sistemit prokurorial përmes komunikatave dhe konferencave të ndryshme.<br><br>PTH Ferizaj:<br>PTH në Ferizaj, gjatë tërë kësaj periudhe raportuese është angazhuar në përdorimin e rrugëve ligjore për mbrojtjen e sistemit prokurorial përmes komunikatave dhe prononcimeve për media, vlen të theksohet se për periudhën raportuese kemi pasur nëntë (9) komunikata/njoftime për media, tetë (8) kërkesa për qasje në dokumente publike, tetëdhjetë e një (81) |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PA:<br>Nuk ka pasur ndonjë zhvillim apo veprim të ndërmarr sa i përket këtij aktiviteti ne PA<br><br>PTH Prishtinë:<br>Në vazhdimësi PTH në Prishtinë është e angazhuar në përdorimin e rrugëve ligjore për mbrojtjen e sistemit prokurorial përmes komunikatave dhe prononcimeve për media, vlen të theksohet se për periudhën raportuese kemi pasur 16 komunikata, 10 kërkesa për casje në dokumente publike, 27 prononcime dhe 360 përgjigjje në pyetje të mediave.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Gjatë kësaj periudhe PTH Ferizaj, ka përdorur të gjitha mekanizmat në mbrojtje të sistemit prokurorial.<br><br>PTH Gjakovë: | pyetje/kërkesa nga mediat të pranuara dhe janë kthyer shtatëdhjetë e tetë (78) përgjigje lidhur me pyetjet/kërkesat e parashtruara.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Ka përdorur të gjitha rrugët ligjore për mbrojtjen e sistemit prokurorial, si dhe duke dhene njoftime sipas vlerësimit dhe nevojave.<br>( 8 komunikata, 48 përgjigje dhe njoftime në lidhje me kërkesat nga portlet dhe mediat, si dhe 6 paraqitje televizive).<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, ka përdorur të gjitha mekanizmat për mbrojtjen e sistemit prokurorial përmes aktiviteteve të ndryshme, përmes komunikatave, njoftimeve, përgjigjeve etj.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Nga Prokuroria Themelore ne Mitrovice janë përdorur të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Janë përdorur të gjitha rrugët ligjore për mbrojtjen e sistemit prokurorial (njoftime etj).<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, gjatë kësaj periudhe raportuese ka përdorur të gjitha mekanizmat për mbrojtje të sistemit prokurorial përmes aktivitetve të ndyshme (njoftime, komunikata, takime).<br><br>PTH Mitrovice:<br>Nga Prokuroria Themelore ne Mitrovice janë përdorur të gjitha rrugët ligjore për mbrojtjen e sistemit prokurorial.<br><br>PTH Peje:<br>Përmes komunikatave dhe konferencave të ndryshme, gjatë kësaj periudhe raportuese janë përdorur të gjitha rrugët për mbrojtjen e sistemit prokurorial. | gjitha rrugët ligjore për mbrojtjen e sistemit prokurorial.<br><br>PTH Peje:<br>Gjatë kësaj periudhe nuk kemi pas raste kur është nevojitur përdorimi i rrugëve ligjore për mbrojtje të Sistemit prokurorial. Sidoqoftë nga përvojat e mëhershme do të veprohet përmes komunikatave dhe konferencave të ndryshme. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Prizren:<br>Nuk kemi pasur raste ku është nevojitur përdorim i rrugëve ligjore për mbrojtje të sistemit prokurorial. | |
| **1.4.2** | Informimi i prokurorëve të shtetit për mundësinë e parashtrimit të ankesave në mekanizmat e kontrollimit të mediave | KPK<br>PSH<br>Zyrat për Komunikim Publik | Janar – dhjetor 2022-2024 | Aktivitetet informuese, të realizuara | ZKPSH:<br>Prokurorët e ZKPSH-së janë të njoftuar për mundësinë e parashtrimit të ankesave në mekanizmat e kontrollit të mediave. Ka prokurorë të cilët kanë ushtruar padi civile në gjykatat kompetente në rastet kur ata kanë konsideruar se shkrimet e mediave janë të pabazuara, cënojnë autoritetin dhe integritetin e tyre personal dhe profesional.<br><br>PTH Prishtinë: Prokurorët janë njoftuar në takime por edhe në kolegjiume për mundësinë që kanë për parashtrimin e ankesave.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në takime të ndryshme, prokurorët janë informuar lidhur me mundësinë e parashtrimit të ankesave në | ZKPSH:<br>Prokurorët e ZKPSH-së janë të njoftuar për mundësinë e parashtrimit të ankesave në mekanizmat e kontrollit të mediave. Ka prokurorë të cilët kanë ushtruar padi civile në gjykatat kompetente në rastet kur ata kanë konsideruar se shkrimet e mediave janë të pabazuara, cënojnë autoritetin dhe integritetin e tyre personal dhe profesional.<br><br>PA:<br>Prokurorët e PA-së janë të njoftuar po ashtu për mundësinë e parashtrimit të ankesave në mekanizmat e kontrollit të mediave. Deri më tani por edhe gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur prokurorë në PA –n të cilët kanë ushtruar padi civile në gjykatat kompetente |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | mëkanizmat kontrollues të mediave.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Prokurorët janë të informuar për mundësinë e tillë.<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, përpos trajnimeve të organizuara për prokurë, të njëjtit në çdo takim të rregullt javor janë njoftuar sa i përket mundësive të parashtrimit të ankesave në mëkanizmat kontrollues të mediave.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Në kolegjiume dhe takime që janë mbajtur me prokuror, janë informuar lidhur me mundësin e parashtrimit të ankesave në mekanizmat kontrollues të mediave.<br><br>PTH Peje:<br>Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Pejë, përmes trajnimeve të ndryshime janë informuar për këtë mundësi. | në rastet kur ata kanë konsideruar se shkrimet e mediave janë të pabazuara, cënojnë autoritetin dhe integritetin e tyre personal dhe profesional.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Në takime të ndryshme që janë mbajtur me prokurorë, të njëjtit janë informuar lidhur me mundësinë e parashtrimit të ankesave në mekanizmat kontrollues të mediave.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në vazhdimësi gjatë takimeve, prokurorët janë informuar lidhur me mundësinë e parashtrimit të ankesave në mekanizmat kontrollues të mediave.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Prokurorët në vazhdimësi janë të informuar për mundësinë e tillë.<br><br>PTH Gjilan: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Po ashtu këtë e kemi spjeguar edhe në kolegjiumet e kësaj prokurorie.<br><br>PTH Prizren:<br>Janë të informuar të gjithë prokurorët për mundësinë e tillë. | Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, prokurorët janë njoftuar në kolegjiumet javore sa i përket mundësisë që kanë për parashtrimin e ankesave.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Prokuroret jane njoftuar ne takime dhe kolegjiume per mundësinë e parashtrimit te ankesave ne mekanizmat e kontrollimit te mediave.<br><br>PTH Peje:<br>Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Pejë, përmes trajnimeve të ndryshime janë informuar për këtë mundësi. Po ashtu këtë e kemi spjeguar edhe në kolegjiumet e kësaj prokurorie. |
| **1.4. 3** | Krijimi i mekanizmit për reagime të shpejta në rastet kur cenohet pavarësia dhe dinjiteti i sistemit | KPK<br>PSH<br>Zyrat për Komunikim Publik | Janar – dhjetor 2022-2024 | Mekanizmat e themeluar<br><br>Personat përgjegj | KPK ka reaguar çdo herë dhe në kohë në rastet kur është cenuar pavarësia dhe dinjiteti i sistemit prokurorial dhe prokurorëve. Në tërësi gjatë kësaj periudhe KPK ka lëshuar 9 reagime/deklarata | ZKPSH:<br>Zyra për Komunikim Publik në ZKPSH së bashku me zyrtarët për komunikim të prokurorive tjera janë në koordinim të vazhdueshëm për përgatijen e reagimeve, demanteve, komunikatave |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | prokurorial në tërësi dhe prokurorëve në mënyrë individuale | | | ës, të caktuar | publike lidhur me raste të tilla.<br><br>ZKPSH:<br>Personat përgjegjës që e mbulojnë këtë fushë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit si dhe zyrtarët tjerë përgjegjës për komunikim me publikun në të gjitha prokuroritë e vendit.<br><br>PTH Prishtinë: Prokurorët gëzojnë mbrojtje maksimale lidhur me ushtrimin e funksionit të tyre, vlen te ceket që në secilin rast kur është bërë edhe përpjekja më e vogël që të cënohet pavarësia apo dinjëteti i tyre janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme ligjore por edhe konsultative.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Gjatë kësaj periudhe, PTH Ferizaj ka përdorur të gjitha mekanizmat lidhur me reagimet e shpejta në rastet | dhe çështjeve tjera sa herë që nëpërmjet deklaratave tendencioze dhe të pasakta cenohet puna e Prokurorit të Shtetit.<br><br>PA:<br>Gjatë periudhës raportuese në PA-n nuk është evidentuar ndonjë rast i tillë i nevojës së reagimit.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Prokurorët në vazhdimësi janë inkurajuar që ti paraqesin rastet e tilla, gjithashtu vlen të theksohet se në këtë drejtim prokurorët që janë përballur me situata të tilla e kanë pasur mbështetjen e plotë të Kryeprokurorit i cili ka ndërmarrë masa të menjëhershme lidhur me trajtimin e tyre, përfshirë këtu demantimin e lajmeve etj.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Gjatë kësaj periudhe, PTH Ferizaj ka përdorur të gjitha |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kur është cenuar pavarësia e prokurorëve.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Çdo herë inkurajohen prokurorët për reagim në rastet e cenimit të të pavarësisë në punën e tyre.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, sipas nevojës në rastet kur cenohet pavarësia e prokurorëve lëshon reagime, njoftime, si dhe prokurorët në<br>mënyrë të vazhdueshme inkurajohen për të paraqitur rastet e tilla.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Prokurorët janë në njoftuar me mekanizmat për reagime të shpejta në rastet kur cenohet pavarësia dhe dinjiteti i sistemit prokurorial në tërësi dhe prokurorëve në mënyrë individuale.<br><br>PTH Peje: | mekanizmat lidhur me reagimet e shpejta në rastet kur është cenuar pavarësia e prokurorëve. Në këto raste lëshohen reagime, njoftime për media.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Prokurorët çdo herë inkurajohen për reagim në rastet e cenimit eventual të pavarësisë në punën e tyre profesionale.<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, prokurorët janë njoftuar sa i përket mekanizmave për reagime të shpejta, në rastet kur cenohet pavarësia dhe dinjiteti i sistemit prokurorial dhe prokurorëve në mënyrë individuale.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Prokuroret cdo here jane njoftuar per te gjitha mekanizmat per reagimet e shpejta lidhur me rastet kur |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Konform kompetencave tona, Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe rregullores për shërbimin e komunikimit në Sistemin prokurorial përmes zyrës së komunikimit kur ka qenë e nevojshme kemi bërë edhe reagime dhe demante. | është cenuar pavarësia e prokurorëve.<br><br>PTH Peje:<br>Konform kompetencave tona, Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe rregullores për shërbimin e komunikimit në Sistemin prokurorial përmes zyrës së komunikimit kur ka qenë e nevojshme kemi bërë edhe reagime dhe demante. |
| | | | | | | |
| **2** | SHTYLLA STRATEGJIKE 2<br>EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI NË NDJEKJEN E KRIMIT | | | | | |
| **2.1** | **Objektivi 1: Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **2.1.1** | Raportimet e rregullta të kryeprokurorëve konform Rregullores për Prokurorin e Shtetit | Kryeprokurorët e prokurorive | Janar – dhjetor 2022-2024 | Raportimet e realizuara | Në baza 3 mujore kryeprokurorët janë ftuar për raportim dhe të njëjtit kanë raportuar me shkrim dhe fizikisht në takimet e KPK-së.<br><br>ZKPSH:<br>Ka pranuar rreth 48 raporte të rregullta të punës nga ana e kryeprokurorëve të prokurorive. | Në baza 3 mujore kryeprokurorët janë ftuar për raportim dhe të njëjtit kanë raportuar me shkrim dhe fizikisht në takimet e KPK-së. Raportet jane te publikuara ne uebportalin e sistemit prokurorial.<br><br>ZKPSH: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Gjakovë:<br>Janë bërë raportime javore për punën e prokurorisë duke njoftuar UD Kryeprokurorin e shtetit, raportime mujore, tre mujore etj, raportime tre mujore në takime të KPK-së, si me rastin e marrjes pjes në kolegjiumet e UD Kryeprokurorit të Shtetit me Kryeprokurorët e Prokurorive Themelore.<br><br>PTH Peje:<br>Bazuar në rregulloren, në mënyrë të vazhdueshme kemi dërguar rapore në KPK dhe PSH, duke përfshirë periudhat tre mujore. Po ashtu kemi qenë të rregullt me raporte 24 orëshe dhe për raste me interes për publikun kemi përpiluar raporte të veçanta, duke përfshirë edhe mbajtjen e konferencave të ndryshme. Si sfidë në këtë drejtim sikruse është përmendur në raportin e kaluar është mungesa e | Ka pranuar rreth 87 raporte të rregullta të punës nga ana e kryeprokurorëve të prokurorive. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | zyrtarëve për statistika në prokurori të nivelit themelore e cila edhe na e ka vështirësuar ndonjëherë raportimin me kohë. Sidoqoftë me avancimin me SMIL-it shpresojmë se kjo të mos jetë çështje problematike. | |
| **2.1.2** | Raportimet e komisioneve të përhershme dhe ad hoc të Këshillit | KPK Komisionet e përhershme dhe ad hoc | Janar – dhjetor 2022-2024 | Raportimet e realizuara | • Komisionet e përhershme të KPK-së raportojnë me shkrim për periudhën 6 mujore dhe vjetore.<br><br>• Komisioni për vlerësimin e performancës së prokurorëve ka raportuar në KPK për përfundimin e tri (3) proceseve të vlerësimit të performancës së prokurorëve gjatë periudhës janar-qershor 2023<br><br>• Të gjitha komisionet ad hoc pas përfundimit të | • Komisionet e përhershme të Këshillit kanë dërguar raportet vjetore 2023 në Këshill të cilat janë bërë pjesë e raportit vjetor të Këshillit<br>• Gjatë periudhës raportuese Komisioni mbikëqyrës për monitorimin e rasteve të Korrupsionit dhe krimeve ekonomike ka realizuar vizita të rregullta nëpër prokuroritë e Kosovës me qëllimit të informimit lidhur me progresin e arritur dhe sfidat në lëndët e Korrupsionit dhe krimeve ekonomike. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | proceseve për të cilat janë themeluar, kanë prezantuar fizikisht në KPK raportet e tyre.<br><br>Koordinatori nacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional hartuar dhe proceduar në KPK dy (2) raporte për Komisionin Ad-Hoc mbikëqyrës për Korrupsion dhe Krime ekonomike:<br>• (D). Raportin vjetor 2022<br>• (E) Raportin gjashtë mujor (janar-qershor 2023).<br>Koordinatori nacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (MNP) ka proceduar në KPK:<br>• (i). Raportin vjetor 2022,<br>• (ii).Raportin tre (3) mujor (janar-mars 2022),<br>• (iii).Raportin gjashtë mujor (janar-qershor 2022), | Për të gjeturat dhe rekomandimet e komisionit është draftuar raport i veçantë i cili është deponuar në KPK.<br>• Të gjitha komisionet ad hoc pas përfundimit të proceseve për të cilat janë themeluar, kanë prezantuar fizikisht në KPK raportet e tyre<br>Koordinatori nacional i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (MNP) ka proceduar në KPK:<br>• (i). Raportin nëntë (9) mujor (janar-shtator 2023),<br>• (ii). Raportin vjetor 2023, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | • (iv).Raportin analitik dhjetë 10 vjeçar (2013-2022), për veprat penale karakteristike, | |
| **2.1.3** | Vlerësim vjetor i performancës së prokurorëve nga eprori | Kryeprokurorët e prokurorive | Janar – dhjetor 2022-2024 | Formularët e vlerësimit vjetor, të hartuar nga eprori | Koordinatori i Komisioneve të përhershme të KPK-së ka hartuar dhe proceduar në KPK, raportin përmbledhës, për KVPP, mbi vlerësimin vjetor (2022) të eprorëve për 170 prokurorë me mandat të përhershëm.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në cilësi të U.D. Kryeprokurorit, në muajin janar 2023 kam bërë vlerësimin vjetorë të pokurorëve për vitin 2022.<br><br>PTH Gjilan:<br>Nga kryeprokurori bëhet vlerësimi vjetor i performancës së punës së prokurorëve.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Kryeprokurori i PTH. Mitrovice ka bere vlerësimin vjetor te prokuroreve per vitin 2022. | Koordinatori i Komisioneve të përhershme të KPK-së ka hartuar dhe proceduar në KPK, raportin përmbledhës, për KVPP, mbi vlerësimin vjetor (2022) të eprorëve për 170 prokurorë me mandat të përhershëm. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Peje:<br>Në fillim të vitit, është bërë vlerësimi i performancës së të gjithë prokurorëve. Procesit të vlerësimit i ka paraprirë analizimi i raporteve të punës së prokurorëve, analizimi i lëndëve dhe të tjera. Raportet e vlerësimet përpos qu u janë dorëzuar prokurorëve, janë dërguar në KPK.<br><br>PTH Prizren:<br>Vlerësimi vjetor i performancës së prokuroreve eshte bere konform ligjit dhe rregulloreve ne fuqi. | |
| **2.1.4** | Mbajtja e kolegjiumeve të rregullta | Kryeprokurorët Prokurorët | Janar – dhjetor 2022-2024 | Kolegjiumet e mbajtura<br><br>Procesverbalet e kolegjiumeve | ZKPSH:<br>Gjatë periudhës raportuese (janar – qershor 2023) janë mbajtur tri (3) kolegjiume me kryeprokurorët e prokurorive dhe prokurorët e ZKPSH-së.<br>Gjithsejtë janë hartuar tri (3) procesverbale të këtyre kolegjiumeve<br><br>PA: | ZKPSH:<br>Gjatë periudhës raportuese (korrik – dhjetor 2023) janë mbajtur tri (3) kolegjiume me kryeprokurorët e prokurorive dhe prokurorët e ZKPSH-së.<br>Gjithsejtë janë hartuar tri (3) procesverbale të këtyre kolegjiumeve<br><br>PA: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | janë mbajtur kolegjiume sipas nevojës brenda periudhës raportuese<br><br>PSRK:<br>Gjatë periudhës janar – qershor PSRK ka mbajtur 6 kolegjiume. të rregullta, në baza mujore si dhe takime te rregullta javore ( sipas nevoje edhe takime ditore ) me udhëheqësit e Departamenteve përkatëse<br><br>PTH Prishtinë:<br>Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur gjithësej 26 kolegjiume të rregullta përfshirë të tri departamentet, po ashtu ka pasur edhe kolegjiume të veçanta që janë mbajtur vetëm me prokurorët e Njesitit për Krime Ekonomike dhe Korrupsion (DKR).<br><br>PTH Gjakovë:<br>Janë mbajtur kolegjiume të rregullata me prokuror për çdo muaj, sipas nevojës edhe | Gjatë periudhës raportuese kam vazhduar me mbejtjën e kolegjiumeve të rregullta me prokurorët e PA-s ku kemi diskutuar për sfidat dhe problemete që prokurorët kanë hasur në punën e tyre të përditshme.<br><br>PSRK:<br>Gjatë kesaj periudhe PS, ka mbajtu 5 kolegiume si dhe takime te rregullta javore me udheheqesit e Departamenteve perkatese.<br><br>PTH Prishtine:<br>Gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtu 36 kolegjiume, pra kolegjiumet janë mbajtur cdo 2 javë.<br><br>PTH Prizren:<br>Kolegjiumet mbahen te rregullta.<br><br>PTH-FERIZAJ:<br>Prokuroria Themelore në Ferizaj, kolegjiumet i mban te rregullta ne baza mujore. Mirëpo, varësisht sipas |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | më shpesh. Në lidhje me kolegjiumet dhe procesverbalet, është njoftuar prokurori nga ZKPSH i caktuar për PTH Gjakovë dhe anëtari i KPK-së nga PTH Gjakovë.<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjlan, kolegjiumet mbahen çdo javë dhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur gjithsej 26 takime të rregullta javore me prokurorë, si dhe sipas nevojës janë mbajtur edhe takime tjera.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Gjate kësaj periudhe raportuese jane mbajuar kolegjiume te rregullta dhe takime me prokuror .<br><br>PTH Peje:<br>Gjatë kësaj periudhe, bazuar në nenin 16 të rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e prokurorit të shtetit kemi bërë përpjekje që | nevojës edhe me shpesh (2 herë në muaj).<br><br>PTH Gjakovë:<br>Janë mbajtur kolegjiume të rregullata me prokuror për çdo muaj, sipas nevojës edhe më shpesh. Në lidhje me kolegjiumet dhe procesverbalet, është njoftuar prokurori nga ZKPSH i caktuar për PTH Gjakovë dhe anëtari i KPK-së nga PTH Gjakovë.<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, mbahen kolegjiume të rregullta javore dhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur 26 kolegjiume, mirëpo sipas nevojës janë realizuar edhe takime ditore.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Gjate kësaj periudhe raportuese jane mbajtur kolegjiume te rregullta dhe takime me prokurorë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | dy herë në muaj të mbajmë të kolegjiume me prokurorët e P.Th. – Pejë ku janë diskutuar tema të ndryshme me interes për këtë prokurori dhe jo vetëm. Në raste të caktuara janë mbajt kolegjiume edhe me departamente veç e veç.<br><br>PTH Prizren:<br>Gjate periudhës raportuese janë mbajtur 13 kolegjiume me prokuror. | PTH Peje:<br>Gjatë kësaj periudhe, bazuar në nenin 16 të rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e prokurorit të shtetit kemi bërë përpjekje që dy herë në muaj të mbajmë të kolegjiume me prokurorët e P.Th. – Pejë ku janë diskutuar tema të ndryshme me interes për këtë prokurori dhe jo vetëm. Në raste të caktuara janë mbajt kolegjiume edhe me departamente veç e veç. |
| **2.1.5** | Monitorimi i punës së prokurorëve nga prokurorët e ZKPSH-së, përgjegjës për secilën prokurori | ZKPSH | Janar – dhjetor 2022-2024 | Pjesëmarrja në kolegjiume | Prokurorët e ZKPSH-së të cilët janë të caktuar për monitorimin e punës së prokurorive në nivel vendi kanë marrë pjesë në takimet e kolegjiumeve të atyre prokurorive që janë të caktuar sa herë që të njëjtit janë ftuar nga kryeprokurorët e prokurorive përkatëse. | Prokurorët e ZKPSH-së të cilët janë të caktuar për monitorimin e punës së prokurorive në nivel vendi kanë marrë pjesë në takimet e kolegjiumeve të atyre prokurorive që janë të caktuar sa herë që të njëjtit janë ftuar nga kryeprokurorët e prokurorive përkatëse. |
| **2.1.6** | Vlerësimi i hedhjeve të kallëzimeve penale dhe | PSH | Janar – dhjetor 2022-2024 | Vlerësimet e bëra | ZKPSH:<br>Në vazhdimësi prokurorët e ZKPSH-së, pranojnë shkresa dhe parashtresa të ndryshme | ZKPSH:<br>Në vazhdimësi prokurorët e ZKPSH-së, pranojnë shkresa dhe parashtresa të ndryshme |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | pushimeve të hetimeve | | | | nga palët kur konsiderojnë se i është pushuar apo hudhur kallëzimi penal. Të gjithë këto shkresa të dërguara në ZKPSH brenda një afati shumë të shkurtë adresohen dhe njoftohen edhe palët për adresimin e tyre. (Kjo praktikë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PA:<br>Në PA pas hyrjes në fuqi të KPPK-ës janë paraparë dispozita të reja që kanë të bëjnë me autorizime të rea të kësaj prokurorie për të vebndosur lidhur me ankesat ndaj aktvendimeve të hedhjes së kallëzimeve penale dhe pushimin tët hetimeve dhe se gjatë kësaj periudhe raportuese ka pasur mjet raste të tilla.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale, i është kushtuar vëmendje e veçantë hudhjeve/ pushimeve, në këtë drejtim | nga palët kur konsiderojnë se i është pushuar apo hudhur kallëzimi penal. Të gjithë këto shkresa të dërguara në ZKPSH brenda një afati shumë të shkurtë adresohen tek prokuroritë përkatëse dhe njoftohen edhe palët për adresimin e tyre. (Kjo praktikë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PA:<br>Në prokurorinë e Apelit gjatë periudhës raportuese numrui i rasteve nën regjistrin AKAP (ku regjistrohen lëndet e ardhura me ankesë ndaj aktvendimeve të prokurorive të shkallës së parë për hedhjen poshtë të kallëzimeve penale dhe pushimin e hetimeve) ka shënuar rritje në vazhdimësi. Të gjitha këto raste të arrituar në PA janë trajtuar brenda afatit ligjor prej 15 ditëve dhe janë vendosur në mënyrë meritore.<br><br>PTH Prishtinë: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Kryeprokurori ka mbështetur në përpikmëri edhe udhëzimin e UD/Kryeprokurorit të Shtetit lidhur me vlerësimin e hudhje dhe pushimeve. Për çdo lëndë që prokurorët vendosin ti pushojnë, pezullojnë hetimet apo ta hudhin kallëzimin penal paraprakisht përpilojnë shënim zyrtarë të cilin së bashku më lëndën e sjellin tek Kryeprokurori për vlerësim dhë nënshkrim.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Gjithnjë vlerësohen, hudhjet e kallëzimeve penale, si dhe pushimet e hetimeve.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Prokurorët pothuajse çdo herë para hudhjes se kallëzimit penal, apo pushimit të hetimeve, janë konsultuar me ud.Kryeprokurorin. Ndërsa nga muaji shkurt 2023 në kuptim të dispozitave ligjore të KPPK- | Në përgjithësi prokurorët konsultohen me Kryeprokurorin në lidhje me hudhjet e kallëzimëve penale apo pushimet e hetimeve, ku ndodhë që në raste specifike edhe udhëzohen nga Kryeprokurori se si të veprojnë në lidhjë me ato raste të cilat ata e shohin të nevojshme.<br><br>PTH Prizren:<br>Kryeprokurori i vlerëson te gjitha vendimet per hudhje te kallëzimeve penale dhe pushim te hetimeve.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, në vazhdimësi njoftojnë kryeprokurorin lidhur me hudhjet e kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve. Po ashtu, të njejtat vlerësohen nga ana e Kryeprokurorit ( hudhjet e kallëzimeve penale dhe pushimet e hetimeve). |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | së dhe udhezimit të detyrueshëm të UD Kryeprokurorit të Shtetit, prokurorët me rastin e hudhjes së kallëzimit penal apo pushimit të hetimeve, konsultohen dhe pas duhet të përpilojnë shenimin zyrtar të cilin duhet nënshkruar Kryeprokurori dhe Prokurori i rastit.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokurorët e Prokurorisë Themelore në Gjilan, në përgjithësi njoftojnë kryeprokurorin lidhur me hudhjet e kallëzimeve penale dhe pushimit të hetimeve, si dhe pas marrjes së këtyre vendimeve çdo kopje qoftë hudhje apo pushim vendoset në dosjen e prokurorëve.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Ne Pth. Mitrovice, në vazhdimësi bëhet vlerësimi i hudhjeve të kallëzimeve penale dhe pushimeve të hetimeve, nga prokurorët, | PTH Gjakovë:<br>Prokurorët çdo herë para hudhjes se kallëzimit penal, apo pushimit të hetimeve, janë konsultuar me Kryeprokurorin dhe në kuptim të dispozitave ligjore të KPPK-së dhe udhezimit të detyrueshëm të UD Kryeprokurorit të Shtetit, prokurorët me rastin e hudhjes së kallëzimit penal apo pushimit të hetimeve, përpilojnë shenimin zyrtar të cilin duhet nënshkruar Kryeprokurori dhe Prokurori i rastit.<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, gjithnjë vlerësohen hudhjet e kallëzimeve penale dhe pushimet e hetimeve. Në secilin rast të hudhjeve apo pushimeve një kopje e vendimit vendoset në dosjen e prokurorëve.<br><br>PTH Mitrovice: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | gjithnjë në konsultim me Kryeprokurorin.<br><br>PTH Peje:<br>Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të procedurës penale, çdo herë para hedhjes së kallëzimit penal dhe pushimit të hetimeve, prokurorët konsultohen me Kryeprokurorin dhe për këtë përpilohet edhe një shënim zyrtar. Këtyre akteve është bërë përpjekje që t'u kushtohet rëndësi e veçantë me rastin e vlerësimit të performancës.<br><br>PTH Prizren:<br>Para çdo Aktvendimi per hudhje te kallëzimit penal dhe pushim te hetimeve behet ne konsultim paraprak me kryeprokurorin dhe mbahet shënim zyrtar konform Kodit te Procedures Penale dhe Udhezimit te Kryeprokurorit te Shtetit. | Janë vlerësuar hudhjet e kallëzimeve penale, si dhe pushimet e hetimeve.<br><br>PTH Peje:<br>Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, me hyrjen në fuqi të Kodit të ri të procedurës penale, çdo herë para hedhjes së kallëzimit penal dhe pushimit të hetimeve, prokurorët konsultohen me Kryeprokurorin dhe për këtë përpilohet edhe një shënim zyrtar. Këtyre akteve është bërë përpjekje që t'u kushtohet rëndësi e veçantë me rastin e vlerësimit të performancës. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.1.7** | Aktivitete për zbatimin e Kodit etik | KPK Akademia e Drejtësisë | Janar – dhjetor 2022-2024 | Aktivitetet e realizuara | Nuk ka pasur | Akademia e Drejtësisë ka organizuar (2) trajnime me temën "Kodi i Etikës dhe sjelljes profesionale "në të cilin kan marrë pjesë (12) prokuror dhe (2) prokuror në këto trajnime kanë ligjëruar në cilësin e trajnuesit . |
| **2.1.8** | Themelimi i një mekanizmi për çështje të etikës së prokurorëve | KPK ZKPSH | Janar – dhjetor 2022-2024 | Mekanizmi i themeluar | KPK ne takimin e mbajtur me 26 qershor 2023 ka miratuar Rregulloren per Komisionin keshilldhenes per etiken e prokuroreve ne baze te te ciles parashihet themelimi i ketij mekanizmi. | Nuk eshte themeluar ne periudhen raportuese |
| | | | | | | |
| **2.2** | **Objektivi 2: Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të pasurisë së fituar me vepër penale (Me theks të posaçëm në zbatimin më efikas të Ligjit për kompetencat e zgjeruara)** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **2.2.1** | Avancimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit | PSH Koordinatori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Takimet e mbajtura | KKLKE:<br>Kanë vazhduar takimet e rregullta të rrjetit të koordinatorëve, me pjesëmarrje të njëjtë të AAPSK, Policisë së Kosovës, partnerëve ndërkombëtar etj. | KKLKE:<br>Janë zhvilluar aktivitete të posaçme të trajnimit tek vepra penale e shpëlarjes së parasë si veper penale e vetme si dhe tek aktiviteti kriminal. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Prishtinë:<br>i kushton rëndësi të veçantë fushës së konfiskimit dhe sekuestrimt, përveç dy prokurorëve që janë caktuar si koordinator për këtë cështje, njëri nga radhët e DP-së tjetri nga DKR, ne çdo kolegjium është diskutuar cështja e lëndëve më sekuestrim dhe konfiskim dhe janë diskutuar zgjidhje të përshtatshme rreth tyre. Për periudhën raportuese kemi pasur gjithësej 49 kërkesa për konfsikim dhe sekuestrim. Po ashtu, korridonatorët në baza mujore përpilojn raporte lidhur me këto lëndë me qëllim të përcjelljes së tyre.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Mbahen takime të rregullta në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit, ku dhe është i caktuar një prokuror koordinator.<br><br>PTH Gjakovë: | Kanë vazhduar takimet e rregullta të rrjetit të koordinatorëve, me pjesëmarrje të njëjtë të AAPSK, Policisë së Kosovës, partnerëve ndërkombëtar etj.<br><br>PTH-Prishtinë:<br>Pasi që ka caktuar koordinatorët për sekuestrim dhe konfiskim, në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore pranon raporte me shkrim, mban takime me korrdinatorët për raste specifike. Gajtë kësaj periudhe raportuese është mbajtur takim edhe me Agjencinë Kosovare për Sekuestrim dhe Konfiskim, më qëllim të ngritjës së bashkëpunimit ndërinstitucional.<br><br>PTH Prizren:<br>Koordinatori i prokurorisë merr pjese ne takimet e përbashkëta me koordinatorin nacional per sekuestrim dhe konfiskim |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Prokurorët në vazhdimësi kanë raportuar te prokurori koordinator për sekuestrim edhe konsfiskime, në lidhje me ratet e tilla dhe koordinatori në vazhdimësi ka raportuar tek koordinatori nacional në ZKPSH.<br>Po ashtu ud.Kryeprokurori vazhdimisht diskuton në lidhje me rastet dhe raportimet per sekuesrtime dhe konsfiskim.<br>Koordinatori po ashtu ka marr pejse në trajnime në lidhje me trajtimin e rasteve të tilla.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan ka caktuar koordinatorin për konfiksim dhe sekuestrim, i cili merr pjesë në takimet e rregullta mujore me koordinatorin nacional për konfiskim dhe sekuestrim të pasurive.<br>Po ashtu, koordinatori ka qenë pjesëmarrës në trajnime lidhur me këtë çështje, të cilat njohuri janë transmetuar | dhe kryeprokurori ka mbajtur takim me drejtorin e AASPK-së.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Koordinatori per sekuestrim dhe konfiskim i caktuar nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka marr pjese ne takime te rregullta lidhur me kete teme.<br>Po ashtu, koordinatori ka marr pjese edhe ne takime te cilat janë organizuar nga koordinatori nacional permes punetorive te ndryshme.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në lidhje me rastet e sekuestrimit dhe konfiskimin e pasurisë, prokurorët kanë raportur tek koordinatori i prokurorisë dhe koordinatori ka raportuar tek koordinatori nacional në ZKPSH.<br>Koordinatori po ashtu ka marr pejse në trajnime në lidhje me trajtimin e rasteve të tilla.<br><br>PTH Gjilan: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | pastaj edhe tek prokurorët dhe bashkëpunëtorët profesional përmes takimeve të rregullta mes prokurorëve dhe kryeprokurorit.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Prokurori koordinator ka mbajtur kontakte me Agjencinë Kosovare për Sekuestrim dhe Konfiskim, më qëllim të ngritjës së bashkëpunimit ndërinstitucional.<br><br>PTH Peje:<br>Me rastin e caktimit të prokurorëve koordinator kemi progres në këto institute procedurale. Bashkëpunimi kryesor për këtë periudhë mund të potencohet me Agjencionin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar.<br>Theks të veçantë i kemi kushtuar aplikimit Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë ku në trajtim e sipër i kemi 6 raste. | Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, i kushtohet rëndësi e veçantë procedurës së konfiskimit dhe sekuestrimit, ku kjo çështje diskutohet edhe në kolegjiumet e rregullta.<br>Prokurori koordinator për konfiskim dhe sekuestrim, merr pjesë në takimet e rregullta mujore me koordinatorin nacional për konfiskim dhe sekuestrim të pasurive, si dhe merr pjesë edhe nëpër trajnime të ndryshme nga kjo fushë, të cilat pastaj transmetohen tek prokurorët dhe bashkëpunëtoret profesional.<br><br>PTH Mitrovice:<br>I eshte kushtuar rendesi, ne Pth. Mitrovice eshte prokurori koordinator per sekuestrime dhe konfiskime dhe jane bere përpjekje per avancim te bashkëpunimit per këto raste.<br><br>PTH Peje: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Prizren:<br>Gjate takimeve tona me hetues policor i diskutojmë ne vazhdimësi çështjet e sekuestrimit dhe koordinatori i PTH Prizren i koordinon punët me te gjitha institucionet tjera relevante. | Me rastin e caktimit të prokurorëve koordinator kemi progres në këto institute procedurale. Bashkëpunimi kryesor për këtë periudhë mund të potencohet me Agjencionin për menaxhimin e pasurisë së sekuestruar dhe konfiskuar.<br>Theks të veçantë i kemi kushtuar aplikimit Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë ku në trajtim e sipër i kemi 6 raste. |
| **2.2.2** | Ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit | PSH Koordinatori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Marrëveshjet e nënshkruara | KKLKE:<br>Ka vazhduar pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin me CARIN, BAMIN, UNDP, OSBE, UNODC, PECK III, ambasadat e ndryshme, AIRE CENTER etj.<br><br>PTH Prishtinë- Prokuroria jonë vazhdon të ruaj raporte të mira me akterët ndërkombëtar në fusha të ndjeshme si në këtë rast. Prokurorët janë obliguar që të marrin pjeë në trajnime të organizuara nga projektet | KKLKE:<br>Ka vazhduar pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin me CARIN, BAMIN, UNDP, OSBE, ROLAG, UNODC, PECK III, ambasadat e ndryshme, AIRE CENTER etj.<br><br>PTH Prishtine:<br>Në këtë periudhë raportuese, jemi munduar që të i profilizojmë prokurorët koordinator për sekuestrm dhe konfiskim duke i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ndërkombëtare lidhur më këto tema me qëllim të marrjës së praktikave të mira dhe aplikimit të tyre në prokurorinë që përfaqësojnë.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në këtë periudhë raportuese, është dërguar prokurorja, njëherit koordintarja për sekuestrim dhe konfiskim në trajtime të ndryshme të organizuara në Republikën e Kosovës, si dhe jashtë vendit.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokurori koordinator në Prokurorinë Themelore në Gjilan, ka mbajtur vazhdimisht takime me koordinatorët e tjerë dhe koordinatorin nacional.<br><br>PTH Peje:<br>Prokurori koordinator në P.Th. Pejë ka pas takime të vazhdueshme me koordinatorin nacional dhe koordinatorët tjerë, ndërsa përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e | dërguar në rajnime të ndryshme të organizuara nga akter vendor dhe ndërkombëtar më qëllim të ngritjës së bashkëpunimit më institucionet ndërkombëtare.<br><br>PTH Prizren:<br>Koordinatori per sekuestrim merr pjese ne takimet me akter ndërkombëtar.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Nga PTH-Ferizaj, koordinatorja e caktuar ka marr pjesë në punëtori të ndryshme ndërkombëtare dhe vendore ne fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit.<br><br>PTH Peje:<br>Prokurori koordinator në P.Th. Pejë ka pas takime të vazhdueshme me koordinatorin nacional dhe koordinatorët tjerë, ndërsa përkitazi me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sekuestrimin dhe konfiskimit mendoj se është më shumë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | sekuestrimin dhe konfiskimit mendoj se është më shumë kompetencë e koordinatorit nacional.<br><br>PTH Prizren:<br>Koordinatori per sekuestrim i PTH Prizren mban takime dhe raporton ne vazhdimësi tek koodrdinatori Nacional per sekuestrim dhe Konfiskim ne ZKPSH, ndërsa raste ku eshte shprehur bashkëpunimi ndërkombëtar nuk ka pasur raste te tilla. | kompetencë e koordinatorit nacional. |
| **2.2. 3** | Mbikëqyrja e punës së prokurorëve në identifikimin e aseteve për sekuestrim | PSH Koordina tori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Raporte t e përgatit ura | KKLKE:<br>Janë përgatitur 2 raporte 3 mujore nga janari deri në qershor 2023 përmes së cilave është paraqitur mbikëqyrja e prokurorëve lidhur me këtë çështje përmes statistikave gjithëpërfshirëse, duke nënkuptuar: datën e marrjes së veprimit, cila prokurori dhe cili prokuror ka ndërmarrë veprimin, llojin e asetit të ngrire/sekuestruar/konfisku ar, vlerën e asetit, etj. | KKLKE:<br>Janë përgatitur 2 raporte 3 mujore nga korriku deri në dhjetor 2023 përmes së cilave është paraqitur mbikëqyrja e prokurorëve lidhur me këtë çështje përmes statistikave gjithëpërfshirëse, duke nënkuptuar: datën e marrjes së veprimit, cila prokurori dhe cili prokuror ka ndërmarrë veprimin, llojin e asetit të ngrire/sekuestruar/konfisku ar, vlerën e asetit, etj. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Prishtinë:<br>Në vazhdimësi kërkohet nga prokurorët që të bëjnë identifikimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale në mënyrë që e njëjta të konfiskohet.<br>Në prokurori kemi krijuar një data-bazë e cila përmban në mënyrë të detajuar të gjitha rastet penale që kanë të përfshirë edhe procedurën e sekuestrimit dhe e njëjta kontrollohet ne baza mujore.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Prokurorët në vazhdimësi mbikëqyren për identifikimin e aseteve për sekuestrim, e po ashtu nga të gjithë prokurorot njoftohet koordinatorja.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Prokurori koordinator, angazhohet dhe komunikon me prokurorët në baza mujore dhe tre mujore, në lidhje me rastet qe kanë të bëjnë me sekuestrim dhe konfiskim. Po ashtu | PTH Prishtine:<br>Rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit kanë vëmendeje të vecantë në PTHP, ku vazhdimisht Kryeprokurori mban takime me koordinatorët si dhe përcjell raportet e përgaditura nga ana e tyre. Po ashtu në vazhdimësi kërkohet nga prokurorët që të bëjnë identifikimin e dobive pasurore të fituar me vepër penale në mënnyrë që e njëjta të konfiskohet.<br>Në prokurori kemi krijuar një data-bazë e cila përmban në mënyrë të detajuar të gjitha rastet penale që kanë të përfshirë edhe procedurën e sekuestrimit dhe konfiskimit.<br>Kemi caktuar dy koordinatorë nga dy Departamentet në DKR dhe DP, të cilët kanë të angazhuar nga një bashkëpunëtorë profesional, të  cilët bëjnë përditësimin e vazhdueshëm të këtyre |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | diskutohet në kolegjiume me prokuror.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, përgatit raporte mujore sa i përket sekuestrimit dhe konfiskimit.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit përcjellën vazhdimisht. Po ashtu kërkohet nga prokurorët që të bëjnë identifikimin e dobise pasurore të fituar me vepër penale në mënnyrë që e njëjta të konfiskohet.<br><br>PTH Peje:<br>Prokurori i koordinator i P.Th. Pejë, u ka ofruar ndihmë prokurorëve në identifikimin e aseteve për sekuestrim dhe gjatë kësaj periudhe janë identifikuar edhe 3 raste në të cilat është aplikuar LKZK-ja dhe janë në trajtim e sipër.<br><br>PTH Prizren: | rasteve  që nga hapi i parë e deri në fazat përfundimtare.<br><br>PTH Prizren:<br>Kjo prokurori raporton ne menyre te rregullte sa i përket sekuestrimit tek koordinatori nacional dhe tek personat tjerë pergjegjes.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në vazhdimësi kërkohet nga prokurorët që të bëjnë identifikimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale në mënyrë që e njëjta të konfiskohet. Ne cdo fundjave, prokuroret te cilët kane paraqitur kërkesa per sekuestrim e njoftojnë koordinatoren.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Prokurorët në vazhdimësi angazhohen raportojnë në baza mujore dhe tre mujore, në lidhje me rastet qe kanë të bëjnë me sekuestrim dhe konfiskim. Po ashtu diskutohet në kolegjiume me prokuror. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Raportohet per rastet qe kane te bëjnë me sekuestrim dhe ne kolegjiumin e prokuroreve diskutohet per sfidat, lidhur me zbatimin e dispozitave te reja te KPP-se per sekuestrim dhe konfiskim. | PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, përpilon raporte mujore lidhur me konfiskimin dhe sekuestrimin e aseteve.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Rastet e sekuestrimit dhe konfiskimit përcjellën vazhdimisht, ne takime dhe kolegjiume eshte kërkuar nga prokurorët që të bëjnë identifikimin e dobise pasurore të fituar me vepër penale në mënnyrë që e njëjta të konfiskohet.<br><br>PTH Peje:<br>Prokurori i koordinator i P.Th. Pejë, u ka ofruar ndihmë profesionale prokurorëve në identifikimin e aseteve për sekuestrim. Mbikëqyrja e punës në këtë drejtim bëhet në mënyrë të vazhdueshme. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.2.4** | Zbatimi i protokolleve për sekuestrim dhe konfiskim | PSH Koordinatori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Protokollet e zbatuara | KKLKE:<br>Gjatë vitit 2023, kemi hartuar shkresat konkrete për secilin nen të KPP-së mbi ngrirjen/sekuestrimin dhe këto kërkesa i janë dërguar të gjithë kryeprokuroreve, në mënyrë që ata ti shpërndajnë tek të gjithë prokurorët.<br>Këto shkresa do të përditësohen dhe harmnizohen edhe njëherë tjetër gjatë vitit 2023.<br>PTH Prishtinë:<br>Sa i përket Ligjit për Kompetenca të Zgjeruara, PTHP deri më tani ka tre (3) raste aktive, të cilat përcjellen vazhdimisht. Ndërkaq sa i përket zbatimit të protokolleve, prokurorët vazhdimisht udhëzohen që të zbatojnë Udhëzuesin për konfiskim dhe sekuestrim.<br><br>PTH Gjakovë<br>Të gjitha protokolet zbatohen.<br><br>PTH Gjilan: | KKLKE:<br>Gjatë vitit 2023, kemi hartuar shkresat konkrete për secilin nen të KPP-së mbi ngrirjen/sekuestrimin dhe këto kërkesa i janë dërguar të gjithë kryeprokuroreve, në mënyrë që ata ti shpërndajnë tek të gjithë prokurorët.<br>Këto shkresa janë përditësuar dhe harmnizuar edhe njëherë tjetër gjatë vitit 2023.<br>Sa i përket Ligjit për Kompetenca të Zgjeruara, PTHP deri më tani ka shtatë (7) raste aktive, të cilat përcjellen vazhdimisht.<br>Ndërkaq sa i përket zbatimit të protokolleve, prokurorët vazhdimisht udhëzohen që të zbatojnë Udhëzuesin për konfiskim dhe sekuestrim.<br><br>PTH-Prishtinë:<br>Sa i përket Ligjit për Kompetenca të Zgjeruara, PTHP deri më tani ka tre (3) raste aktive, të cilat përcjellen vazhdimisht. Ndërkaq sa i përket zbatimit të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, koordinatori prokuror në kolegjiumet e rregullta, ka kërkuar nga prokurorët që të zbatohen protokollet për sekuestrim dhe konfiskim.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Zbatimi i protokolleve standarde dhe udhëzuesve për sekuestrimin, ngrirjen dhe konfiskimin e aseteve përmes veprimeve të përditshme të prokurorëve në rastet kur ka sekuestrim/konfiskim.<br><br>PTH Peje:<br>Përmes prokurorit koordinator është kërkuar nga prokurorët që të respektojnë të gjitha aktet dhe protokollet e sekuestrimit dhe konfiskimit.<br><br>PTH Prizren:<br>PTH Prizren ka nje rast kur eshte zbatuar LKZK (rasti PP.nr.1214-14/21). Ndersa, sa | protokolleve, prokurorët vazhdimisht udhëzohen që të zbatojnë Udhëzuesin për konfiskim dhe sekuestrim.<br><br>PTH Prizren:<br>Te gjithë prokuroret janë te informuar lidhur me udhëzimet dhe protokollet per sekuestrim dhe konfiskim dhe i përmbahen atyre. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | i përket protokolleve zbatohen ne çdo rast. | |
| **2.2.5** | Rritja e numrit të kërkesave për shitje të pasurive të propozuara për konfiskim | PSH Koordinatori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Numri i kërkesave për konfiskim | KKLKE:<br>Në gjashtëmujorin e vitit 2023 kanë përfunduar 4 raste me konfiskim vlera e aseteve të konfiskuara është 3,557,891.64, janë bërë 7 kërkesa për shitje të automjeteve<br><br>PTH Prishtinë:<br>Në vazhdimësi bashkëpunon me akterë kompetent në drejtim të rritjes se kërkesave për shitjen e aseteve te konfiskuara si dhe njekohësisht Kryeprokirori i ka inkurajuar prokurorët që në rastet që ka përfunduar procedura me vendim të formës së prerë asetet të shiten dhe të kthehen në mjete buxhetore për RKS.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në vazhdimësi inkurajohen prokurorët për të paraqitur kërkesa të tilla.<br>Në cilësi të UD Kryeprokurorit kam bërë | KKLKE:<br>Në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2023 kanë pasur një rast të jashtëzakonshëm me konfiskim vlera e aseteve të konfiskuara është 20,000,000.00, janë bërë 3 kërkesa për shitje të automjeteve<br><br>PTH-Prishtinë:<br>Pas takimit që është mbajtur me AKKS, është vendosur që të ngritët bashkëpunimi dhe të gjenden rrugë të përbashket në drejtim të koordinimit për shitjen e pasurive të propozuara për konfiskimi, njëherit janë inkurajuar prokurorët që në rastet që ka përfunduar procedura me vendim të formës së prerë asetet të shiten dhe të kthehen në mjëtë buxhetore për RKS.<br><br>PTH Prizren: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kërkesa për dhënin në shfrytëzim të sendeve të konfiskuara për organet publike.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, mban takime sipas nevojës me prokurorë lidhur me kërkesat për shitjen e pasurive të propozuara për konfiskim.<br><br>PTH Prizren:<br>PTH ne Prizren pothuajse ne çdo rast kur kemi te bëjmë me pasuri te luajtshme, te cilave i humbet vlera, parashtron kerkese per shitje ne Gjykate. | Prokuroret ne vazhdimësi bëjnë kerkese per shitje te pasurive te sekuestruara ne gjykatat kompetente. |
| **2.2.6** | Mbikëqyrja e veprimeve të prokurorëve lidhur me parashtrimin apo jo të kërkesave për konfiskim | PSH Koordinatori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Raporte t e përgatitura | KKLKE:<br>Janë përgatitur 2 raporte 3 mujore nga janari deri në qershor 2023 përmes së cilave është paraqitur mbikëqyrja e prokurorëve lidhur me këtë çështje.<br><br>PTH Prishtinë:<br>Në Prokurorinë Themelore në Prishtinë përpilohen | KKLKE:<br>Janë përgatitur 2 raporte 3 mujore nga korriku deri në dhjetor 2023 përmes së cilave është paraqitur mbikëqyrja e prokurorëve lidhur me këtë çështje.<br><br>PTH-Prishtine:<br>Mbikqyrja e Kryeprokurorit të PTHP bëhët përmes |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | raporte të rregullta 6 mujore përmes të cilave mbikëqyren veprimet e prokuroreve ne kete drejtim.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Prokurorët në vazhdimësi mbikëqyren lidhur me veprimet e ndërmarra për konfiskim.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në vazhdimësi në komunikim me prokuror, mbikqyren dhe diskutohet lidhur me parashtrimin e kerkesave për konfiskim.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Mbikeqyren veprimet e prokuroreve lidhur me parashtrimin apo jo te kërkesave per konfiskim.<br><br>PTH Peje:<br>Kjo është bërë përmes prokurorit koordinator.<br><br>PTH Prizren: | analizimit të raportove mbi bazën e veprimeve të ndërmarra nga ana e prokurorëve, dhe në raste specifike mbahen edhe takime konsultative me ta.<br><br>PTH Prizren:<br>Prokuroret çdo 3 muaj raportojnë tek kryeprokurori lidhur me veprimet e ndërmarra per secilën lende.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Prokurorët në vazhdimësi mbikëqyren lidhur me veprimet e ndërmarra për konfiskim duke e njoftuar koordinatoren lidhur me kërkesat e paraqitura për konfiskim.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në vazhdimësi në komunikim koordinatorin dhe me prokuror, mbikqyren dhe diskutohet lidhur me parashtrimin e kerkesave për konfiskim.<br><br>PTH Gjilan: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Mbikeqyrja behet ne baze te raporteve te rregullta te tyre dhe vendimeve gjyqesore. | Në Prokurorinë Themelore në Gjilan vazhdimisht mbikëqyren veprimet e prokurorëve lidhur me parashtrimin apo jo të kërkesave për konfiskim.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Jane mbikeqyrur veprimet e prokuroreve lidhur me parashtrimin apo jo te kërkesave per konfiskim<br><br>PTH Peje:<br>Kjo është bërë përmes prokurorit koordinator. |
| **2.2.7** | Mbajtja e takimeve të rregullta të Koordinatorit Nacional me koordinatorët e prokurorive për konfiskim | Koordinatori Nacional Koordinatorët regjionalë | Janar – dhjetor 2022-2024 | Takimet e mbajtura | KKLKE:<br>Ka vazhduar mbajtja e takimeve të rrjetit të koordinatorëve.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokurori koordinator në Prokurorinë Themelore në Gjilan, pas takimeve të rregullta me koordinatorin regjional raporton tek prokurorët e tjerë përmes takimeve të rregullta brenda prokurorisë. | KKLKE:<br>Ka vazhduar mbajtja e takimeve të rrjetit të koordinatorëve.<br><br>PTH-Ferizaj:<br>Koordinatorja e PTH Ferizaj ka mbajtur takime të rregullta me koordinatorin nacional.<br><br>PTH Gjakovë: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Mitrovice:<br>Sipas nevojës Koordinatori Regjional mban takim me Koordinatorin Nacional<br><br>PTH Peje:<br>Koordinatori regjional ka mbajt takime të rregullta me koordinatorin nacional dhe në mënyrë të vazhdueshme ka raportuar edhe në kolegjiumet e Prokurorisë Themelore në Pejë.<br><br>PTH Prizren:<br>Koordinatori i PTH Prizren ka mbajtur takime të rregullta me koordinatorin nacional. | Koordinatori i PTH Gjakovë ka mbajtur takime me koordinatorin nacional.<br><br>PTH Gjilan:<br>Koordinatori për sekuestrim dhe konfiskim merr pjesë në takime të rregullta me koordinatorin nacional, ku më pas raporton tek prokurorët e tjerë përmes takimeve javore ose sipas nevojës.<br><br>PTH Peje:<br>Koordinatori regjional ka mbajt takime të rregullta me koordinatorin nacional dhe në mënyrë të vazhdueshme ka raportuar edhe në kolegjiumet e Prokurorisë Themelore në Pejë. |
| **2.2.8** | Rishikimi i Udhëzimit për konfiskim | KPK Koordinatori Nacional | Janar – dhjetor 2022-2024 | Udhëzimi i rishikuar | ZKPSH:<br>Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, me 24 Prill 2023, ka nxjerrë Udhezuesin e Thjeshtëzuar për Konfiskim në Kosovë, i cili ka për qëllim unifikimin e praktikave të prokurorëve të shtetit lidhur | KKLKE:<br>Në tetor të vitit 2023 është lansuar Udhëzuesi i Thjeshtësuar për zbatimin e dispozitave të konfiskimit në KPRK, KPP dhe LKZK. Ky Udhëzues është përditësuar dhe kompletuar me infrastrukturën ligjore. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | me fushën e konfiskimit të pasurisë pas hyrjes në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Penale.<br><br>KKLKE:<br>Në tetor të vitit 2023 është lansuar Udhëzuesi i Thjeshtësuar për zbatimin e dispozitave të konfiskimit në KPRK, KPP dhe LKZK. Ky Udhëzues është përditësuar dhe kompletuar me infrastrukturën ligjore. | |
| | | | | | | |
| **2.3** | **Objektivi 3: Zvogëlimi i numrit të lëndëve të Prokurorit të Shtetit, me theks të veçantë në lëndët nga regjistri PPP** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Tregues i | | |
| **2.3.1** | Vlerësim dhe analizë e lëndëve me kryes të panjohur (PPP) | PSH | Janar – mars 2022 | Analiza e hartuar | ZKPSH:<br>Hartimi i raporteve të rregullta për të gjitha lëndët, përfshirë edhe ato me PPP nga ana e prokurorive. (Kjo praktikë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br>PSRK:<br>PSRK ka bërë një analizë të rasteve me kryes të panjohur | ZKPSH:<br>Hartimi i raporteve të rregullta të punës për të gjitha lëndët, përfshirë edhe ato me PPP nga ana e prokurorive. (Kjo praktikë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PTH-Prishtinë: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | (PPP) nga e cila rezulton se aktualisht ne PSRK janë 525 raste me PPP, prej tyre 513 i përkasin Departamentit për Krime Lufte, ndërsa 4 i përkasin Departamentit për Terrorizëm dhe 8 Departamentit për Krim te Organizuar<br><br>PTH Prishtinë:<br>Kryeprokurori kërkon nga prokurorët që vëmendje e vecant të i kushtohet rasteve me PPP, të njëjtit janë udhëzuar që në rast se ka arritur parashkrimi psolut të njëjtat të hudhen posht, në rastet të tjera të rifreskohen autorizimet dhe të ndërmirren veprime tjera procedurale. Vëmendje e veçant i kushtohet rasteve të vrasjeve. Lidhur me këto vepra penale interesimi për zbulimin e kryerësve është shumë me rëndësi pasi që me mos zbulim in e tyre kemi edhe amnestim të kriminalitetit në përgjithësi. | Pothuajse në cdo kolegjium Kryeprokurori kërkon nga prokurorët që vëmendje e vecant të i kushtohet rasteve me PPP, të njëjtit janë udhëzuar që në rast se ka arritur parashkrimi psolut të njëjtat të hudhen posht, në rastet të tjera të rifreskohen autorizimet dhe të ndërmirren veprime tjera procedurale.Gjithashtu si mekanizëm mbikëqyrës për lëndët me PPP sidomos ato të vrasjeve Kryeprokurori ka caktuar një ditë ku pret në takiim së bashkur me prokurorët e rasiteve familjarët e të ndjerëve.<br><br>PTH Prizren:<br>Për çdo muaj raportohet per lendet me kryes te panjohur (regjistri PPP) dhe kërkohet nga prokuroret qe ti analizojnë dhe vlerësojnë kallëzimet penale me kryes te panjohur dhe te parashtrojnë kërkesa per grumbullim te te dhënave ne Polici. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Ferizaj:<br>Vlerësohen gjithnjë lëndët me kryerës të panjohur (PPP), dhe aty ku ka arritur parashkrimi absolut, mbyllen me Raport për Mbyllje të Rastit, kurse, për raste të tjera vazhdimisht bëhet kërkesë për zbulimin e kryerësve të panjohur.<br><br>PTH Gjakove:<br>Vazhdon të mbetët një sfide per prokurorine pasi keto raste janë në rritje e siper, në vazhdimësi diskutohet me prokuror dhe në rastet e tilla nga prokurorët çdo her paraqiten kërkesa në polici për marrjen e veprimeve hetimore me çëllim të zbulimit dhe identifikimit të kryersëve të veprave penale. Një nga pengesat ka qenë edhe numri i vogël i prokurorëve dhe se tani jemi në drejtim të normalizimit lidhur me numrin e prokurorëve dhe lëndëve të pranuara. | PTH-Ferizaj:<br>Prokurorët rastet me kryerës të panjohur në vazhdimësi i shqyrtojnë, aty ku është e nevojshme në çdo 3-6 muaj, bëjnë kërkesa për zbulimin e kryersëve të panjohur, si dhe i shqytojnë rastet aty ku ka arritur parashkrimi absolut.<br><br>PTH Gjakove:<br>Ende është sfide numri i rasteve PPP, në vazhdimësi prokurorët paraqesin kërkesa në polici për marrjen e veprimeve hetimore me çëllim të zbulimit dhe identifikimit të kryersëve të veprave penale.<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, në takimet javore vlerësohen dhe analizohen lëndet PPP, me kryes të panjohur, analizohet çdo herë se a kanë arritur parashkrimin absolut, ku këto raste mbyllen, ndërsa në rastet e tjera bëhen vazhdimisht kërkesa për |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, në çdo kolegjium vlerësohen dhe analizohen lëndet PPP, me kryes të panjohur, analizohet çdo herë se a kanë arritur parashkrimin absolut, ku këto raste mbyllen, ndërsa në rastet e tjera bëhen vazhdimisht kërkesa për zbulimin e kryesve të panjohur.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Ne kolegjium te prokuroreve jane diskutuar trajtimi i lendeve me kryes te panjohur dhe eshte kerkuar nga prokuroret qe ti rishikojne te gjitha lendet me PPP dhe te parashtrojne kerkesa ne Polici.<br><br>PTH Peje:<br>Lëndët me kryes të panjohur janë sfiduese dhe mendoj se duhet marrë një qëndrim nga ZKPSH dhe KPK se si duhet të veprohet me to pasi të jenë shter të gjitha vepriemt e | zbulimin e kryesve të panjohur dhe ndërmirren veprime të tjera procedurale.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Ne kolegjiume te mbajtura, prokuroret jane udhëzuar qe te trajtojnë lendet me kryes te panjohur dhe eshte kerkuar nga prokuroret qe ti rishikojne te gjitha lendet me PPP dhe te parashtrojne kerkesa ne Polici.<br><br>PTH Peje:<br>Lëndët me kryes të panjohur janë sfiduese dhe mendoj se duhet marrë një qëndrim nga ZKPSH dhe KPK se si duhet të veprohet me to pasi të jenë shter të gjitha vepriemt e ndërmarra. Sidoqoftë në kolegjium janë diskutuar këto lëndë dhe është kërkuar nga prokurorët që t'i trajtojnë në mënyrë të vazhdueshme deri në identifikimin e kryesve të atyr veprave penale. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ndërmarra. Sidoqoftë në kolegjium janë diskutuar këto lëndë dhe është kërkuar nga prokurorët që t'i trajtojnë në mënyrë të vazhdueshme deri në identifikimin e kryesve të atyr veprave penale.<br><br>PTH Prizren:<br>Për çdo muaj raportohet per lendet me kryes te panjohur (regjistri PPP) dhe kërkohet nga prokuroret qe ti analizojnë dhe vlerësojnë kallëzimet penale me kryes te panjohur dhe te parashtrojnë kërkesa per grumbullim te te dhënave ne Polici. | |
| **2.3.2** | Hartimi i Udhëzuesit me rekomandime për trajtimin e rasteve me kryes të panjohur (PPP) | PSH | Prill - qershor 2022 | Udhëzuesi i hartuar | Nuk është raportuar se është ndërmarrë ndonjë veprim | Nuk është raportuar se është ndërmarrë ndonjë veprim |
| **2.3.3** | Trajtimi i rasteve me kryes të panjohur (PPP) në koordinim | PSH | Janar – mars 2022 | Takimet e realizuara me Policinë | ZKPSH:<br>Diskutimet e rregullta lidhur me këto raste nga niveli menaxhues - kryeprokurorët me Policinë e Kosovës, | PTH-Prishtinë:<br>Në baza mujore mbahen takim me policinë ku me theks të vecant si problematike janë paraqitur |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | me Policinë e Kosovës | | | e Kosovës | kërkesat e vazhdueshme të prokurorëve për zbulim të këtyre rasteve, etj. (Një praktikë e tillë ka vazhuar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PTH Prishtinë:<br>Çështja e lëndëve me kryes të panjohur është gjithmonë çështje diskutimi në takimet e rregullta mes Prokurorisë dhe Policisë, kjo për shkak të natyrës sfiduese të këtyre rasteve. Në vazhdimsi bëhen përpjekeje për gjetjen e metodave të përshatatshme për trajtimin e këtyre rasteve.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në çdo 6 muaj, përsëritet kërkesa për zbulimin e kryerësve të panjohur.<br><br>PTH Gjakove:<br>Në kolegjiumet me prokuror, por edhe në takimet me polici, diskutohet në lidhje me rastet me kryerës të panjohur të veprave penale me qëllim të identifikimit të | tek të dy institucionet rastet me kryes të panjohur (PPP), Kryeprokurori ka mbajtur edhe takime specifike për diskutimin e këtyre rasteve ku është kërkuar nga PK që të i bashkërendojmë veprimet lidhur me trajtimin e këtyre lëndëve.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në çdo 3-6 muaj, përsëritet kërkesa për zbulimin e kryerësve të panjohur.<br><br>PTH Gjakove:<br>Në komunikim me prokuror dhe polici diskutohet në lidhje me rastet me kryerës të panjohur të veprave penale me qëllim të identifikimit të kryerësve të veprave penale dhe zvogëlimin e këtyre lëndëve.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, në çdo takim të rregullt me Policinë e Kosovës diskuton çështjen e rasteve me kryer të panjohur |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kryerësve të veprave penale dhe zvogëlimin e këtyre lëndëve.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, në koordinim me Policinë e Kosovës, pas analizimit të këtyre rasteve vazhdimisht bënë kërkesa të cilat drejtohen në polici lidhur me zbulimin e kryesve të panjohur.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Në koordinim me Policine e Kosoves trajtohen rastet PPPme kryerës të panjohur të veprave penale.<br><br>PTH Peje:<br>Gjatë takimeve të rregullta me Policinë e Kosovës, janë diskutuar edhe rastet e kësaj natyre por edhe përkundër kësaj, sfidë mbetet mënyra e trajtimit të tyre.<br><br>PTH Prizren:<br>Çdo 3 muaj prokuroret i analizojnë dhe vlerësojnë | (PPP), për shkak të sfidave që paraqiten tek këto raste.<br>Në mënyrë të vazhdueshme bëhen kërkesa nga prokurorët, të cilat adresohen tek policia, sa i përket zbulimit të këtyre kryesve të veprave penale.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Jane paraqitur kërkesa Policise dhe ne koordinim me Policine eshte bere trajtimi i rasteve te tilla.<br><br>PTH Peje:<br>Gjatë takimeve të rregullta me Policinë e Kosovës, janë diskutuar edhe rastet e kësaj natyre por edhe përkundër kësaj, sfidë mbetet mënyra e trajtimit të tyre. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kallëzimet penale me kryes te panjohur dhe parashtrojnë kërkesa per grumbullim te te dhënave ne Polici. | |
| | | | | | | |
| **2.4** | **Objektivi 4: Bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet e tjera relevante për rritjen e efikasitetit në hetimin dhe zbulimin e veprave penale dhe inicimin e rasteve penale** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **2.4.1** | Ngritja e komunikimit dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës lidhur me inicimin e rasteve penale | PSH | Janar – dhjetor 2022-2024 | Takimet e mbajtura | ZKPSH:<br>Takimet e rregullta të kryeprokurorëve dhe prokurorëve të rasteve me të gjithë akterët e sundimit të ligjit, veçanërisht me Policinë e Kosovës. (Një praktikë e tillë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PTH Prishtine:<br>Prokuroria Themelore në Prishtinë mban takime të rregullta me udhëheqësit e divizioneve të ndryshme të Policisë së Kosovës, me qëllim të diskutimit lidhur me inicimin e rasteve dhe mbarëvajtjen e procedurave | ZKPSH:<br>Takimet e rregullta të U.D. Kryeprokurorit të Shtetit me kryeprokurorët e PTH-ve dhe prokurorët e rasteve, me përfaqësues të Policisë së Kosovës, Inspektoriatit të Policisë, ATK-se, Doganës etj. (Një praktikë e tillë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PTH-Prishtinë në baza ditore mban takime me hetuese te sektorëve të ndryshme, pastaj në baza mujore mbahen takime me të gjithë zingjirin komandues të Policisë së Kosovës lidhur me problematikat dhe |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | në drejtim te hetimit të rasteve të tilla.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Mbahen takime të rregullta me Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës/Ferizaj, si dhe me hetuesit e të gjitha stacioneve policor të regjionit në Ferizaj.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Realizohen kontaktet e vazhdueshme në mes të policisë dhe prokurorisë, po ashtu takime të ndryshme polici – prokurori lidhur me bashkepunimin dhe rritjen e efikasitetit në punë dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, përpos komunikimeve të rregullta në mes policisë dhe prokurorëve kujdestar, mban, mban edhe takime të rregullta me policinë, me qëllim të rritjes së | bashkërendimin e veprimve me PK në rastet e inicimit të rasteve penale.<br><br>PTH Prizren:<br>Mbahen takime te shpeshta me shefat e hetimeve te Stacioneve Policore dhe te Regjionit, si dhe me komandantet e stacioneve policore dhe drejtorin rajonal te Policisë lidhur me sfidat apo problemet ne trajtimin e rasteve.<br><br>PTH-FERIZAJ:<br>Mbahen takime të rregullta me Drejtorinë Rajonale të Policisë së Kosovës/Ferizaj, si dhe me hetuesit e të gjitha stacioneve policor të regjionit të Ferizajt.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Mbahen kontakte të kohëpaskohshme në mes të policisë dhe prokurorisë, lidhur me bashkepunimin dhe rritjen e efikasitetit në punë dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | bashkëpunimit dhe efikasistetit në punë.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Ne takimet me Policine e Kosoves jane diskutuar inicimi i rasteve penale dhe mbarëvajtja e procedurave në drejtim te hetimit të rasteve të tilla.<br><br>PTH Peje:<br>Kjo çështje është pikë e veçantë edhe e Planit për menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Pejë. Me qëllim edhe të realizimit të kësaj pike dhe ngritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës lidhur me inicimin e rasve penale, kemi mbajt takime të rregullte ku çdo herë edhe janë nxjerr edhe konkluzione të caktuara, të cilat pastaj janë monitoruar. Takime të rregullta kemi mbajt edhe me njësite të veçanta policore.<br><br>PTH Prizren: | PTH Gjilan:<br>Me qëllim të ngritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, lidhur me inicimin e rasteve penale, Prokuroria Themelore në Gjilan realizon takime të rregullta me udhëheqësit e divizioneve të ndryshme të Policisë së Kosovës.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Jane mbajtur takime me Policine me qellim te ngritjes se komunikimit dhe bashkëpunimit lidhur me inicimin e rasteve dhe mbarëvajtjen e procedurës te hetimit te rasteve.<br><br>PTH Peje:<br>Kjo çështje është pikë e veçantë edhe e Planit për menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Pejë. Me qëllim edhe të realizimit të kësaj pike dhe ngritjes së komunikimit dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës lidhur me |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Mbahen takime te shpeshta me shefat e hetimeve te Stacioneve Policore dhe te Regjionit, si dhe me komandantet e stacioneve policore dhe drejtorin rajonal te Policisë. | inicimin e rasve penale, kemi mbajt takime të rregullte ku çdo herë edhe janë nxjerr edhe konkluzione të caktuara, të cilat pastaj janë monitoruar. Takime të rregullta kemi mbajt edhe me njësite të veçanta policore. |
| **2.4.2** | Ngritja e komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera relevante lidhur me inicimin e rasteve penale | PSH | Janar – dhjetor 2022-2024 | Takimet e mbajtur a | ZKPSH:<br>Takimet e rregullta me Policinë, ATK-në, Inspektoratin Policor, Doganën e Kosovës, Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Zyrën Kombëtare të Auditimit, Autoritetin Kosovar të Konkurrencës, etj.<br><br>PSRK:<br>Bashkëpunimi me institucionet e zbatimit të ligjit realizohet edhe përmes Ekipit të Përbashkët për Përzgjedhjen dhe Shenjëstrimin e Krimeve të Rënda, në takime të rregullta, ku gjate kësaj periudhe janë mbajtur 3 takime dhe janë | ZKPSH:<br>Gjatë periudhës raportuese U.D. Kryeprokurori i Shtetit ka pasur takime me përfaqësues të institucioneve zbatuese të ligjit.<br><br>PTH-Prishtinë:<br>Në drejtim të ngritjës së bashkëpunimit ndërinstitucianal mbahen takime me Doganën e Kosovës, KHAIA, AKP, AIP, IPK etj.<br><br>PTH Prizren:<br>Kryeprokurori dhe koordinatorja e rasteve lidhur me dhunën ne familje, te PTh Prizren mbajne takime te shpeshta dhe jane në kontakt të vazhdueshëm me |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | shenjestruar 4 raste te reja, ku janë te perfshire 57 persona.<br><br>PTH –Prishtinë<br>Kryeprokurori në kuadër të agjendës dhe fushëveprimit të tij mban takime të niveleve të ndryshme me institucione të ndryshme ligjzbatuese me qëllim të njoftimit të tyre lidhur obligimin e tyre ligjor për denoncimin e rasteve sipas legjislacionit në fuqi.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Janë mbajtur takime të rregullta me hetuesit të Doganave, si dhe me ATK dhe Institucione të tjera relevante.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Ka bashkepunim me institucione të ndryshme lidhur me inicimin e rasteve penale, duke përfshir policinë, dogana, ATK, agjencioni pyjor etj.<br><br>PTH Gjilan: | të gjitha institucionet relevante, në drejtim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur takime të rregullta me hetuesit doganor, Inspektoret e ATK-së dhe Institucionet tjera relevante, me qëllim të bashkëpunimit të ndërsjelltë ndërinstitucional.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Bashkepunim me institucione të ndryshme lidhur me inicimin e rasteve penale, duke përfshir policinë, dogana, inspektoratin policor etj.<br><br>PTH Gjilan:<br>Prokuroria Themelore në Gjilan, përpos me policinë mban takime të rregullta edhe me institucionet e tjera lidhur me inicimin e rasteve penale (siç janë: Inspektorati |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, përpos takimeve të rregullta me Policinë, mbahen takime edhe me institucionet e tjera shtetërore si psh., Doganën, Inspektoratin Policor të Kosovës Administratën Tatimore të Kosovës dhe institucione tjera, me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me inicimin e rasteve penale.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Me qellim te ngritjes se komunikimit dhe bashkëpunimit, jane mbajtur takime ne forma te ndryshme me institucionet relevante lidhur me inicimin e rasteve penale.<br><br>PTH Peje:<br>Me qëllim të luftimit sa më efikas të kriminalitetit, në kuadër të Planit vjetor për menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Pejë, siç u cek bashkëpunimit ndërinstitucional i është | Policor i Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, Doganën dhe institucionet e tjera relevante), me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me inicimin e rasteve penale.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Me qellim te ngritjes se komunikimit dhe bashkëpunimit, jane mbajtur takime ne forma te ndryshme me institucionet relevante lidhur me inicimin e rasteve penale.<br><br>PTH Peje:<br>Me qëllim të luftimit sa më efikas të kriminalitetit, në kuadër të Planit vjetor për menaxhimin e Prokurorisë Themelore në Pejë, siç u cek bashkëpunimit ndërinstitucional i është kushtuar rëndësi e veçantë, prandaj edhe janë mbajt takime me zyrtar të ATK-së, Policinë e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe të tjera. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kushtuar rëndësi e veçantë, prandaj edhe janë mbajt takime me zyrtar të ATK-së, Policinë e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe të tjera.<br><br>PTH Prizren:<br>Kryeprokurori dhe koordinatorja e rasteve lidhur me dhunën ne familje, te PTh Prizren mbajne takime te shpeshta dhe jane në kontakt të vazhdueshëm me të gjitha institucionet relevante, në drejtim të ngritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional. | |
| | | | | | | |
| **2.5** | **Objektivi 5: Rritja e efikasitetit në aplikimin e procedurave alternative për zgjidhjen e rasteve penale** | | | | | |
| **Nr.** | Aktiviteti | Njësia përgjegjëse | Afati kohor | Treguesi | | |
| **2.5.1** | Rekrutimi i zyrtarëve për ndërmjetësim në prokuroritë themelore | KPK | Janar – dhjetor 2022 | Zyrtarët e rekrutuar | KPK në vazhdimësi ka bërë kërkesa për lejimin e buxhetit për rekrutimin e këtyre zyrtarëve mirëpo këto kërkesa nuk janë miratuar nga Qeveria. Momentalisht në të gjitha prokuroritë themelore janë të caktuar | KPK në vazhdimësi ka bërë kërkesa për lejimin e buxhetit për rekrutimin e këtyre zyrtarëve mirëpo këto kërkesa nuk janë miratuar nga Qeveria. Momentalisht në të gjitha prokuroritë themelore janë të caktuar |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | zyrtarë me detyrë shtesë ndërmjetësimin. | zyrtarë me detyrë shtesë ndërmjetësimin. |
| **2.5. 2** | Ngritja e përqindjes së rasteve të referuara me procedura alternative | PSH | Janar – dhjetor 2022 - 2024 | Perqindje më e lartë e rasteve të referuara me procedura alternative | Gjatë periudhës janar – qershor 2023, nga numri total i rasteve të pranuara në prokuroritë themelore (11,407 kallëzime penale - PP në të gjitha prokuroritë themelore) nga Prokurori i Shtetit përmes procedurave alternative, janë zgjidhur 1,070 raste apo 9.38% me 1,554 persona (nga 11,994 persona të zgjidhur) apo 12.95% të personave | Gjate vitit 2023, Prokurori i Shtetit nga numri total i rasteve te zgjidhura te regjistrave PP dhe PPM (21,821 raste) me procedura alternative ka zgjidhur 2,746 apo 12.5% te rasteve te zgjidhura. |
| **2.5. 3** | Fuqizimi i komunikimit mes prokurorisë dhe ndërmjetësuesve | PSH KPK | Janar – dhjetor 2022 - 2024 | Takimet e mbajtura | PTH Prishtinë:<br>Gjatë periudhës raportuese ka mbajtur takim me dy zyrtarët e ndermjetësimit në kuadër te Prokurorisë nga të cilat ka kërkuar të informohet lidhur me mbarvajtjen e punës se tyre si dhe sfidat që hasin në realizmin e detyrave të tyre. Kjo me qëllim të fuqizimit dhe bashkërendimit të veprimeve midis dy institucioneve. | PTH Prizren:<br>Ndermjetesuesit kane komunikim te rregullte me prokurorinë përmes zyrtarit per ndërmjetësim.<br><br>PTH-Ferizaj:<br>Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur takime me ndërmjetësues sipas kërkesave te tyre. Po ashtu, edhe takime të rregullta.<br><br>PTH Gjakovë: |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | PTH Ferizaj:<br>Janë mbajtur takime lidhur me procedurat e ndërmjetësimit me ndërmejtësit.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Kryeprokurori në vazhdimësi i udhëzon prokurorët që sa më shumë raste te zgjidhen me procedura alternative kur ekzistojnë kushtet ligjore.<br><br>PTH Peje:<br>Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, ka mbajt takime lidhur me procedurat e ndërmjetësimit, e po ashtu kontakte të rregullta me ndërmjetësues janë mbajtur edhe përmes zyrtarit për ndërmjetësim.<br><br>PTH Prizren:<br>Ndermjetesuesit kane komunikim te rregullte me prokurorinë përmes zyrtarit per ndërmjetësim. | Zyrtarja për ndërmjetësim e prokurorisë, ka kontakte të rregullta me ndërmjetësues.<br><br>PTH Gjilan:<br>Zyrtari për ndërmjetësim mban takime të rregullta me ndërmjetësuesit, me qëllim të fuqizimit të komunikimit.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Gjate periudhes raportuese jane mbajtur takime me ndermjetesues lidhur me procedurat e ndërmjetësimit.<br><br>PTH Peje:<br>Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Pejë, ka mbajt takime lidhur me procedurat e ndërmjetësimit, e po ashtu kontakte të rregullta me ndërmjetësues janë mbajtur edhe përmes zyrtarit për ndërmjetësim. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **2.5.4** | Udhëzime për prokurorë për përdorimin e shtuar të procedurave alternative për zgjidhjen e rasteve | PSH | Janar – dhjetor 2022 - 2024 | Udhëzimet e ofruara për prokurorët | ZKPSH:<br>Në vazhdimësi – sqarime rreth zbatimit të udhëzimit për zgjedhjen e rasteve alternative. (Kjo ka praktikë ka vazhduar edhe gjatë periudhës raportuese).<br><br>PTH Prishtinë:<br>Në këtë drejtim Kreyprokurori kërkon nga prokurorët që të rritet numri i rasteve në të cilat aplikohen procedurat alternative në këtë mënyrë duke i inkurajuar prokurorët që në ato raste kur lejohen të aplikohen këto procedura të njëjtat të aplikohen sa më shumë në mënyrë që të kemi një shkarkim të lëndëve në prokurori e të cilat në një mënyrë apo tjetrën do të ketë impakt pozitiv edhe për gjykatën. Ajo që vlen të theksohet është se edhe në rastet kur organizohen trajnime me tema te tilla i dërgon prokurorët që kane numër më të vogël të marrëveshjeve për pranim të | PTH Prizren:<br>Kryeprokurori ne vazhdimësi i udhëzon dhe nxite prokuroret qe te kryejnë raste me procedura alternative. Gjate vitit 2023 i kemi kryer 262 kallezime penale me ndërmjetësim dhe 123 aktakuza me marrëveshje per pranimin e fajësisë.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Në kolegjiumet e rregullta me prokuror, çdo herë udhëzohen prokurorët për shtimin e rasteve për aplikimin e procedurave alternative.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në vazhdimësi udhezohen dhe inkurajon prokurorët që të referojnë rastet në proceduat alternative, kur plotësohen kushtet ligjore<br><br>PTH Gjilan:<br>Në Prokurorinë Themelore në Gjilan, kryeprokurori në kolegjiumet e rregullta javore, në mënyrë të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | fajësisë ose numër më të vogël të rasteve të referuara në ndërmjetësim.<br><br>PTH Ferizaj:<br>Udhëzon në vazhdimësi prokurorët që sa më shumë raste te zgjidhen me anë të procedurave alternative, gjithnjë kur ekzistojnë kushtet ligjore.<br><br>PTH Gjakovë:<br>Në vazhdimësi UD Kryeprokurori udhezon dhe inkurajon prokurorët që të referojnë rastet në procedurën e ndërmjetësimit, çdo her kur plotësohen kushtet ligjore<br><br>PTH Gjilan:<br>Gjatë takimeve të rregullta javore, kryeprokurori vazhdimisht udhëzon prokurorët që në rastet kur plotësohen kushtet ligjore të aplikojnë procedurat alternative sa i përket zgjidhjes së rasteve, pasi që janë më të favorshme për | vazhdueshme udhëzon prokurorët që në rastet kur plotësohen kushtet ligjore të aplikojnë procedurat alternative për zgjidhjen e rasteve, pasi janë procedura më të shpejta dhe janë më të favorshme për kryerësit.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Ne takime dhe kolegjiume te mbajtuara prokuroret jane udhëzuar qe te aplikojnë procedurave alterantive per zgjidhjen e rasteve.<br><br>PTH Peje:<br>Kryeprokurori, gjatë mbajtjes së kolegjiumeve, në mënyrë të vazhdueshme i udhëzon prokurorët për përdorimin e procedurave alternative, të cilat do t'i shërbenin përshpejtimit të procedurës penale. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | kryerësit e veprave penale dhe janë procedura më të shpejta.<br><br>PTH Mitrovice:<br>Ne kolegjiume dhe takime janë udhëzuar prokurorët për aplikimin e procedurave alternative<br><br>PTH Peje:<br>Kryeprokurori, gjatë mbajtjes së kolegjiumeve, në mënyrë të vazhdueshme i udhëzon prokurorët për përdorimin e procedurave alternative, të cilat do t'i shërbenin përshpejtimit të procedurës penale.<br><br>PTH Prizren:<br>Ne vazhdimësi kërkohet nga prokuroret qe te zbatojnë sa me shume procedurat alternative ne zgjidhjen e rasteve. | |
| **2.5.5** | Mbikëqyrja sistematike dhe raportimi i rregullt i zgjidhjes së | PSH | Janar – dhjetor 2022 - 2024 | Mbikëqyrja e realizuar | ZKPSH:<br>Një raport tremujore i punës dhe një (1) raport gjashtëmujor i punës së Prokurorit të Shtetit për | ZKPSH:<br>Një raport nëntë mujor i punës dhe një (1) raport vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit, ku pasqyrohet |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
